

E DREJTA PARLAMENTARE DHE POLITIKAT LIGJORE

2003

Në këtë numër:

Nga debati parlamentar për mediat
Reforma institucionale dhe
Integrimi European

- Përafrimi i legjislacionit shqiptar me legjislacionin komunitar
- Shqipëria dhe Europa:
Perceptime dhe realitete

E Drejta Kushtetuese

- Mbi ankimin individual dhe përzgjedhjen e ankesave në Gjykatën Kushtetuese

14

Botim i Qendrës së Studimeve Parlamentare

PËRMBAJTJA E REVISTËS:

Numri XIV, viti 2003

Faqe

Debati parlamentar mbi mediat:

Musa ULQINI	4
Pjetër ARBNORI	9
Vili MINAROLLI	13
Preç ZOGAJ	17

Reforma institucionale dhe Integrimi Europian:

Përafrimi i legjislacionit shqiptar me legjislacionin komunitar –proces vendimtar për Integrimin Europian	Ledi BIANKU	20
--	-------------	----

Shqipëria dhe Europa: Perceptime dhe realitete

Raymond DETREZ	35
----------------	----

E Drejta Kushtetuese:

Mbi ankimin individual dhe përzgjedhjen e ankesave në Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë dhe më gjerë	Denar BIBA	47
--	------------	----

Nga punimet e Kuvendit:

Nga punimet e Kuvendit për periudhën prill - korrik 2003	Alma KONDAKÇI	60
Informacion mbi legjislacionin e miratuar	Filip LAKO	75

Përmbledhje në anglisht:

Albania and Europe: Perceptions and Realities	Raymond DETREZ	90
Informacion mbi legjislacionin e miratuar		102

TABLE OF CONTENTS:

14th issue, year 2003

	Page	
<hr/>		
Parliamentary debate on media:		
Musa ULQINI	4	
Pjetër ARBNORI	9	
Vili MINAROLLI	13	
Preç ZOGAJ	17	
<hr/>		
Institutional Reform and European Integration:		
Approximation of Albanian legislation with EU legislation – e decisive process for the European integration		
Ledi BIANKU	20	
Albania and Europe: Perception and realities		
Raymond DETREZ	35	
<hr/>		
Constitutional Law:		
An comperative overview on individual complaint and preliminary review of petitions addressed to the Constitutional Court of Albania		
Denar BIBA	47	
<hr/>		
Parliamentary proceedings:		
Report on parliamentary proceedings during the period April - July 2003		
Alma KONDAKÇI	60	
Information on laws passed by the Assembly		
Filip LAKO	75	
<hr/>		
Summary in English:		
Albania and Europe: Perceptions and realities	Raymond DETREZ	90
Information on laws passed by the Assembly	Filip LAKO	102

Rubrikat në vijim synojnë prezantimin e politikave ligjore dhe trajtimeve teorike për organizmin dhe funksionimin e institucioneve kushtetuese. Botuesi vlerëson si një kontribut në zhvillimin dhe përmirësimin e funksionimit të institucioneve kushtetuese, paraqitjen e opinioneve dhe mendimeve të studjuesve të ndryshëm, në mënyrë të paanëshme dhe objektive, duke nxitur një debat profesional.

Opinionet e paraqitura janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin e botuesit të kësaj reviste.

Diskutim për mocionin për debat me Kryeministrin për mediat

*Musa Ulqini
Deputet*

*I nderuar zoti Kryetar,
Të nderuar kolegë deputetë,*

Që në krye të kësaj fjale, në emër të Grupit Parlamentar Socialist, dua të theksoj se shqetësimet e ngritura nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike nuk kanë asgjë të përbashkët me shqetësimet e vërteta që ka media dhe bashkësia e gazetarëve në Shqipëri.

Përpyekja e lidërshiptit të Partisë Demokratike për t'u identifikuar si mbrojtës i lirisë së fjalës e të medias në Shqipëri është një aksion politik që i paraprin fushatës së zgjedhjeve vendore që zhvillohen këtë vjeshtë dhe synon që përmes presionit dhe demagogjisë të vendosë mbi mediat ndikimin e vet politik.

Të nderuar kolegë deputetë,

Nëse ka një fushë ku zhvillimi i shënuar gjatë viteve të qeverisjes socialiste nuk mund të krahasohet me vitet e qeverisjes demokratike, kjo fushë është pa dyshim ajo e medias.

Gjatë viteve të qeverisjes së Partisë Demokratike në Shqipërisë nuk u lejua zhvillimi i mediave elektronike private. RTSH-ja ishte një transmetues shtetëror, një zëdhënës tërësisht i kontrolluar i lidërshiptit të Partisë në pushtet.

Shtypi i pavarur përfaqësohej kryesisht nga një e përditshme, gazetarët e së cilës iu nënshtruan një represioni të vërtetë policor. Gjatë viteve të qeverisjes së Partisë Demokratike u dogjën redaksi gazetash dhe u burgosën gazetarë të pavarur.

Legjislacioni për mediat dhe informimin e publikut ose mungonte, ose ishte represiv.

Kontrulli i Partisë në pushtet mbi mediat gjatë qeverisjes së Partisë Demokratike ishte i drejtpërdrejtë dhe i hapur dhe për këtë arsye reagimi i faktorit ndërkombëtar ishte publik dhe mjaft i ashpër. Kjo situatë e mediave në kohën e qeverisjes së Partisë Demokratike nuk ishte për shkak të mungesës së përvojës dhe të mosnjohjes së standardeve demokratike, por për shkak të konceptit antidemokratik që lidheshi i PD-së kishte dhe ka edhe sot e kësaj dite për mediat dhe rolin e tyre.

Gjatë viteve të qeverisjes socialiste në Shqipëri, mediat njohën një zhvillim të jashtëzakonshëm për shkak të klimës së re politike të krijuar në vend dhe të konceptit të qartë të kësaj qeverisjeje për rolin e medias e të gazetarëve në një shoqëri demokratike.

Gjatë kësaj periudhe dolën në transmetim dhe morën licencë 120 operatorë radiotelevizivë. Sot në Shqipëri industria radiotelevizive zhvillohet me shpejtësi dhe është orientuar drejt teknologjive moderne digjitale. Media elektronike ka krijuar mundësi të shumta për informim alternativ të publikut të gjerë për gjithë problematikën e zhvillimit të vendit. Me nisma të posaçme ligjore, të inicuar nga mazhoranca socialiste, është ulur disa herë pagesa vjetore për licencë dhe taksat për çdo frekuencë. Këto nisma ligjore kanë ndihmuar në zhvillimin e industrisë radiotelevizive në Shqipëri.

Gjatë këtyre viteve janë hedhur hapa thelbësorë për transformimin e RTSH-së nga një transmetues shtetëror në një transmetues publik. Është një realitet i pamohueshëm fakti që RTSH-ja informon publikun me standarde të reja, ku pozita dhe opozita janë të pranishme pothuajse në mënyrë të barabartë, diçka e paimagjinueshme gjatë viteve të qeverisjes së Partisë Demokratike.

Edhe media e shkruar ka njohur zhvillim të vullshëm. Sot në Shqipëri botohen rreth 20 të përditshme politike, informative, kombëtare me teknologji të njëjta me simotrat europiane, duke krijuar një larmi të madhe në fushën e informimit publik.

Ndërkohë që në fushën e legjislacionit, që garanton fjalën e lirë dhe lirinë e informacionit, ndryshimet janë thelbësore. Mazhoranca socialiste ka miratuar një sërë ligjesh që garantojnë lirinë e fjalës dhe zhvillimin e mediave të pavarura, si dhe të drejtën e qytetarëve për të pasur akses në informacionin zyrtar. Ligji për mediat elektronike, me amendimet e bëra është kthyer në një instrument të fuqishëm që garanton dhe mbron interesat e medias elektronike shqiptare. Ndërkaq në fuqi është një ligj mjaft demokratik për median e shkruar. Po kështu, ligji për të drejtën e qytetarëve për t'u informuar për dokumentet shtetërore është një hap në drejtimin e duhur. Në zbatim të këtij ligji sot në tërë hierarkinë e administratës shtetërore po zhvillohen me shpejtësi sektorët e marrëdhënieve me publikun dhe zyrat e shtypit. Ndërkohë, ligji për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror u ka krijuar mediave akses të gjerë për t'u njohur me dokumentet shtetërore dhe ka minimizuar abuzimin e nëpunësve të shtetit me sekretin shtetëror. I një rëndësie të veçantë është edhe ligji për privatizimin. I gjithë ky korpus është hartuar në zbatim të parimeve të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë që flasin për lirinë e fjalës dhe të drejtën e informimit.

Në zbatim të këtij legjislacioni, gjatë këtyre viteve u transformuan institucionet ekzistuese ose u ngritën institucione krejt të reja. Kështu për shembull, u krijua institucioni i Avokatit të Popullit dhe prej gati katër vjetësh vepron Enti Rregullator i Medias Elektronike (KKRT).

Si konkluzion, sot në Shqipëri askush nuk mund të thotë që media nuk është e lirë. Por nuk është realiste të themi që media funksionon tërësisht sipas standardeve demokratike.

Të ndërgjegjshëm për rolin e medias në një shoqëri demokratike dhe për sfidat që bashkësia e gazetarëve përballon çdo ditë, më poshtë po theksojmë disa probleme që janë edhe shqetësim i mazhorancës socialiste.

1. Përmirësime në legjislacion.

Nisma ligjore, si ajo e Kryeministrit Nano, për t'i dhënë fund piraterisë radiotelevizive në fushën e mediave elektronike, që u përshëndet publikisht

nga shumica e pronarëve të mediave elektronike, janë të nevojshme edhe për çështje të tjera në fushën e zhvillimit të mediave. Gjithnjë e më shumë është e nevojshme që Shqipëria të ketë një ligj të standardeve demokratike për median e shkruar, për projektin e të cilit është punuar gjatë. Janë të mirëpritura nisma të tilla ligjore, në mënyrë të veçantë nga bashkësia e gazetarëve.

2. Zbatimi me korrektesë i ligjit.

Gjithnjë e më shumë merr rëndësi të dorës së parë zbatimi i ligjit në fuqi nga operatorët radiotelevizivë. KKRT-ja dhe institucionet e tjera shtetërore, si dhe pronarët e mediave komerciale duhet të garantojnë sidomos konkurrencën e ndershme dhe transparencën për paratë që shpenzohen në sektorin e mediave. Në këtë mënyrë ne do t'i bëjmë një shërbim shumë të madh zhvillimit të mediave sipas standardeve demokratike, duke mos lejuar keqpërdorimin e tyre nga askush për interesa parciais e partiaks.

3. Akses i në informacion

Ndërsa zyrat e shtypit në tërë hierarkinë e administratës publike kanë njohur një zhvillim të vrullshëm, duke i mundësuar mediave një informacion të shpejtë dhe profesional, në fushën e marrëdhënies me qytetarët ka ende mangësi dhe nevojitet një përmirësim cilësor i marrëdhënies nëpunës-qytetar në fushën e informimit.

4. Përfundimi i procesit të kthimit të RTSH-së në transmetues publik.

RTSH-ja është i vetmi transmetues që mbahet nga taksapaguesit shqiptarë dhe me një fuqi të madhe informuese. Kanali i parë dhe kanali i dytë eksperimental, transmetimi satelitor, studiot në rrethe, Radio Tirana me kanalet e saj, transmetimi në teletëkst, mbulimi i 80 për qind sipërfaqe të vendit e bëjnë RTSH-në fuqinë më të madhe informative në vend. Për këtë arsye është detyrë parësore e KD të RTSH-së dhe e drejtuesve të këtij institucioni të përshpejtojnë procesin e kthimit të RTSH-së në një transmetues të mirëfilltë publik.

5. Statusi i gazetarit

Ne besojmë që bashkësia e gazetarëve duhet të vetorganizohet në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të gazetarëve. Asnjë e drejtë nuk i është dhunuar askujt, pra as gazetarëve. Është detyrim i kësaj bashkësie të vetorganizohet sipas modeleve perëndimore, për të garantuar zbatimin e etikës gazetareske. Ligji është i njëjtë për të gjithë. Gazetarët duhet të kuptojnë se profesioni i tyre fisnik nuk mund të keqpërdoret në dëm të askujt. Natyrisht edhe politikanët duhet të kuptojnë se si njerëz publikë ata duhet të pranojnë “riskun”, për të qenë objekt i shpeshtë i mediave. Gjithashtu, është jetike për këtë bashkësi vetorganizimi i tyre në sindikata, në mënyrë që të mbrojnë në mënyrë të organizuar të drejtat e tyre. Ndërkaq, organet shtetërore të ngarkuar me ligj duhet të bëjnë gjithë presionin e nevojshëm që pronarët e mediave t’u garantojnë punonjësve të medias siguracionet dhe t’i punësojnë ato sipas kontratave ligjore të punës.

6. Sugjerime dhe rekomandime të institucioneve ndërkombëtare

Për shkak të specifikës së mediave dhe rëndësisë që ka ajo në një shoqëri demokratike, institucione të ndryshme ndërkombëtare, që nga Departamenti Amerikan i Shtetit dhe deri te prania e OSBE-së në Shqipëri, kanë bërë dhe bëjnë vlerësime për median shqiptare dhe problemet e saj. Ne i vlerësojmë sugjerimet dhe rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare për mediat, por ne gjykojmë se të gjithë aktorët e këtij sektori duhet të mbajnë shënim për kritikën që bëhen dhe të bëjnë përmirësimet e duhura, larg çdo politizimi dhe keqpërdorimi të këtyre sugjerimeve, kritikave dhe rekomandimeve për nevojat politike të ditës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke respektuar të drejtën që ka dhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike për të debatuar për çështje të ndryshme me Kryeministrin në sallën e këtij Kuvendi, grupi i mazhorancës e vlerëson si politike përmbajtjen e mocionit për debat me Kryeministrin dhe, në tërësinë e vet, e hedh poshtë Projektrezolutën e paraqitur për miratim.

Pjetër Arbnori
Deputet

Liria e shtypit, e shprehjes ekziston prej vitesh në Kushtetutë. Gazetat janë të lira, televizionet lulëzojnë, asnjë censurë paraprake nuk mund të pengojë të drejtën e çdo qytetari të lirë për të thënë atë që mendon. Por të gjitha këto ekzistojnë vetëm formalisht. Një ngërç i rëndë ekziston në lirinë e masmedias. Një listë e gjatë drejtorësh, kryeredaktorësh, analistësh të njohur në të gjithë vendin ankohen publikisht se liria e shtypit është vënë në rrezik. Fill pas kësaj vjen një letër nga personalitete botërore që merren me lirinë e masmedias, të cilët shqetësohen për cënimet e lirisë së shtypit në Shqipëri nga ana e Qeverisë dhe, si të mos mjaftonte kjo, ditët e fundit botohet një Raport i OSBE-së në Këshillin e Përhershëm për gjendjen politike në Shqipëri. Një nga kapitujt e rëndësishëm të këtij Raporti për Shqipërinë është edhe “Liria e medias”, në të cilën thuhet shprehimisht: “Çështje që lidhen me lirinë e medias në Shqipëri janë bërë kohët e fundit subjekte të rëndësishme diskutimesh për gazetarët, pronarët e mediave dhe politikanët. Zgjedhjet vendore që po afrojnë i kanë dhënë këtij debati një tjetër kuptim dhe mund të jenë në të vërtetë shkak kryesor që i vendos çështjet e medias në qendër të vëmendjes. Në veçanti vëmendje i është kushtuar mënyrave se si interesat e biznesit të medias ndërthuren me interesat e politikanëve, disa prej të cilëve janë edhe vetë pronarë mediash, dhe shkallës së ndikimit të ushtruar në media me qëllim fitimin e avantazheve politike... Duke i inkurajuar operatorët e mbrojtur politikisht, që të mos i marrin parasysh standardet e vendosura me ligj... Duke qenë se rreth 60 për qind e reklamave në media paguhet nga

institucionet shtetërore ose të financuara nga Buxheti i Shtetit, reklamimi i sponsorizuar nga Qeveria është bërë mjeti më efikas për të ushtruar presion mbi median... Shumica e mediave janë bërë haptazi proqeveritare në raportimet e tyre.”

Edhe Komisioni i Përhershëm për të Drejtat e Njeriut, Minoritetet dhe Peticionet është sensibilizuar për shumë probleme të shkeljes së të drejtave të njeriut në lidhje me masmediat. Sekretari i këtij Komisioni, pasi ka biseduar me Kryetarin, Zëvendëskryetarin dhe shumë anëtarë të Komisionit, ka kërkuar një mbledhje të tij, ku të shqyrtohej themelisht çështja e lirisë së medias, mbështetur në vërejtjet e medias së lirë, por edhe mbështetur në vërejtjet e lëshuara nga prania e OSBE-së në vjeshtën e kaluar, nga Departamenti Amerikan i Shtetit, Zyra e Demokracisë, e të Drejtave të Njeriut, Grupi Ndërkombëtar i Krizave dhe raporti i zotit Liponen sivjet në Vjenë. Në mbledhjen e Komisionit patë një mirëkuptim lidhur me trajtimin e temës së lirisë së shtypit dhe, si përfundim, u propozua që të zhvillohej një mbledhje e zgjeruar e Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe Komisionit për Mjetet e Informimit Publik, në praninë e personaliteteve të shtypit dhe gazetarëve të njohur, para fundit të qershorit.

Ditë më parë kemi biseduar me Kryetarin dhe Sekretarin e Komisionit për Mjetet e Informimit Publik, të cilët dhanë pëlqimin për një mbledhje të përbashkët, por thanë se nuk do të ishin në Shqipëri për shkak të udhëtimit në Beograd dhe në vende të tjera. Pastaj ata nuk u ndien më dhe nuk e bëmë mbledhjen e përbashkët.

Deputeti Arbnori i shkroi një letër Presidentit të Republikës, Alfred Moisiu, lidhur po me këtë temë të rëndësishme.

Disa nga problemet e shtruarra dhe që dua t'i përsëris këtu janë se të metat dhe kritikrat e bëra lidhur me mediat publike e të pavarura, janë të hershme, në mos më të zgjeruara e të rënduara sot.

Kryeministri i Shqipërisë, Fatos Nano, sipas ankesave të shprehura dhe të përsëritura në shtyp po përdor Buxhetin e Shtetit për të blerë shtypin dhe

mediat e pavarura; mjetet financiare shtetërore, veç të tjerave, përdoren me anën e reklamave shumëmilionëshe të favorizuara.

Kjo situatë është theksuar në raporte të lëshuara nga prania e OSBE-së, Departamenti Amerikan i Shtetit dhe Grupi Ndërkombëtar i Krizave, të cilët vërejnë, gjithashtu, se bizneset private kanë gjithnjë e më shumë frikë se mos, duke u reklamuar nga media antiqeveritare, rrezikojnë të bëhen objekt i kontrolleve financiare. Si përfundim, shumica e mediave në raportimet e tyre janë bërë haptazi proqeveritare.

Çështjes së lirisë së medias iu kushtua më shumë vëmendje në muajin shkurt, kur gazetarët që po transmetonin debatin në një seancë plenare të Kuvendit mbi mocionin e opozitës për krijimin e një komisioni hetimor për Kryetarin e Bashkisë së Tiranës, u lanë jashtë ndërtesës gjatë votimit përfundimtar, i cili u refuzua nga shumica. Gazetarë të njohur e denoncuan këtë akt si censurë dhe në kundërshtim me Rregulloren e brendshme të Kuvendit. Ngjarja shkaktoi një diskutim të gjerë publik mbi shkallën e ndikimit të Qeverisë në media. Një numër në rritje rastesh akuzimi për shpifje, ngritur nga politikanë kundër gazetarëve, vetëm sa i kanë rritur këto shqetësime.

Kryeministri i Shqipërisë ka ndërmarrë një fushatë kërcënimesh me eliminim fizik të disa përfaqësuesve të mendimit të pavarur, analistë e botues.

Është krimi i organizuar, mbështetur nga Qeveria e Kryeministri, që përpiqet të vendosë kodin e heshtjes ndaj medias së pavarur.

Kryeministri ushtron presion ndaj medias së pavarur dhe opozitare për t'i blerë, duke u ofruar nënshtrim ose falimentim. Pushteti ka filluar një duel të hapur me njerëzit e medias, duke angazhuar për këtë qëllim të gjitha hallkat e pushtetit gjyqësor.

Prokuroria dhe gjykatat ushtrojnë presion psikologjik dhe dënojnë gazetarët, me qëllim që t'u mbyllet goja.

Kodi i mafias, pasi është bërë sundues në të gjitha aspektet e jetës së shoqërisë shqiptare, po synon të bëhet kod sundues edhe në fjalën e lirë.

Në krye të Radiotelevizionit Publik Shqiptar gjendet një njeri i zgjedhur, i cili ka disa muaj që nuk lejon funksionimin e Këshillit Drejtues të RTSH - së.

Mjeti i vetëm shtetëror i informimit publik është kthyer në një operator në shërbim të Kryeministrit.

Drejtues të Qeverisë dhe të pushtetit vendor zotërojnë mjete private të informimit publik, financohen me para me origjinë të dyshimtë të drogës dhe prostitucionit ose të trafikut ilegal dhe janë qendra të pastrimit të parave.

Një sërë tituj gazetash të pavarura të opozitës janë të dënuara ose përgatiten të dënohen sipas padive.

Një numër intelektualësh të shquar analistë dhe botues të njohur janë bërë viktime të presioneve.

Tani është gjetur një marifet i ri, për t' u pasuruar me anë të vendimeve të gjyqit, për të falimentuar median kundërshtare.

Kryetari i Misionit të OSBE-së, Liponen ka kritikuar kohët e fundit Qeverinë për dhunim të lirisë së shtypit dhe dihet që Kryetari i OSBE-së nuk ka treguar kurrë preferencë për njërin ose palën tjetër.

Vili Minarolli
Deputet

Zoti Kryetar,

Ajo që ndodhi sot në këtë sallë konkretizon shqetësimin që lidhet me pavarësinë e medias. Ne flasim për mbrojtjen e lirisë së shtypit, dhe vetë media, si rrallë herë në këtë sallë, nuk është e pranishme, sepse gazetarëve dhe operatorëve iu dha urdhër të mos e regjistrojnë këtë seancë, që në një farë mënyre godet interesat e pronarëve dhe të segmenteve politike, të cilëve ata u shërbejnë.

Debati që zhvilluam tregoi se shqetësimi i opozitës dhe i institucioneve ndërkombëtare ndaj cënimit të pavarësisë së mjeteve të informimit publik nga ana e pushtetit, për standardet e një shoqërie demokratike, është real.. Në pozicionin e mbrojtësit, disa nga diskutantët e mazhorancës u bashkuan realisht me shqetësimet e mësipërme, por zgjidhjen e adresuan jo atje ku duhet. Diskutimet argumentuan se pushteti po përdor me dhunë dhe abuzivisht të gjitha instrumentet e shumta që ka në dorë, për t'i mbyllur të gjitha shtigjet shprehjes së mendimit opozitar dhe të mendimit të lirë e të pavarur. Edhe komuniteti ndërkombëtar, pas shumë vitesh të demokracisë së mbetur në tentativë, i lodhur nga tualeti i politikës sonë false, po flet hapur se pushteti, që s'mund të kuptohet pa personat konkretë që janë pushtetarët, me Kryeministrin e vendit në krye, ka cënuar lirinë e shtypit dhe pavarësinë e tij. Pohim ky, së fundi, edhe nga Zëvendëskryeministri i vendit.

Forma më klasike e trashëguar nga e kaluara diktatoriale, por edhe më e kamufluara, për shkak të propagandës dhe sofistikut, është *censura* që shprehet në mungesën e informimit ose të informimit të shtrembëruar. Të marrim RTSH-në si mjetin e vetëm publik të informimit për të gjithë shqiptarët që, edhe pas pesë vjetësh të miratimit të ligjit, ka mbetur pronë e shtetit, pra e Qeverisë. Kjo me instrumentin e saj KKRT, spekulon kur thotë se nga sondazhet, p.sh., lideri i mazhorancës dhe i opozitës janë paraqitur me të njëjtën kohë në buletinet informative. Pas këtyre sekondave, RTSH-ja është në dispozicion të Qeverisë dhe të qeveritarëve për punët e tyre shtetërore e private, për propagandë partiake dhe informacione të deformuara për mbarë publikun. Por ka akoma më keq, kur censura shfaqet në formën e *black out-it*, për një për qindje të konsiderueshme të publikut. TV publik nuk shikohet ose gjoja shikohet në më shumë se 40 për qind të territorit të vendit dhe kemi disa vjet që justifikohemi se tranzicioni na dëmtoi aparaturat përforcuese. Ndërkohë, që ne të gjithë, madje këtë herë edhe ZP-ja, jemi dëshmitarë të vjedhjeve qindra milionëshe nga drejtuesit e RTSH-së, që mund t'i kishin zëvendësuar dy ose tri herë aparaturat e duhura, ashtu siç jemi dëshmitarë që prej disa muajsh kemi vendosur shkarkimin e KD-së të RTSH-së si shkaktar i abuzimeve dhe i shkatërimit të institucionit dhe që e vazhdon këtë veprimtari ashtu siç është, edhe i qenë, edhe i paqenë. Ju pyes, a nuk është censurë që privohet mbi 40 për qind e publikut nga e drejta e informimit dhe pjesa tjetër merr atë që i jep Qeveria? Për këtë TV paguajnë të gjithë shqiptarët.

E njëjta gjë ndodh edhe me TV-të e tjera që kanë licencë kombëtare. Mbulojnë njeri 27 për qind dhe tjetri 40 për qind, të territorit të vendit katër vjet pas licensimit zyrtar, kur që ditën e parë duhej të mbulonin 70 për qind dhe pas gjashtë vjetëve 95 për qind të tij.

Këtu u fol se krimi i organizuar ose, siç tha një prej ministrave dy ditë më parë, mafia e integruar ka shtënë në dorë median. Vetë Kryeministri e ka pohuar këtë para disa muajsh. Por ai e ka në dorë ta pengojë ose ta lejojë

këtë dukuri, siç po bën faktikisht. Ligji lejon dhe mundëson me instrumentet përkatëse kontrollin financiar të të gjithë medias, por deri tani nuk është bërë, për t'i lënë dorë të lirë financimeve të dyshimta dhe pastrimit të parave. Jemi vendi që kemi më shumë tituj gazetash për frymë të popullsisë dhe, në të njëjtën kohë, vendi që për frymë të popullsisë e blejmë më pak. Pra, shtypi nuk është biznes fitimi. Ç'tregon kjo? Që sot numrin më të madh të gazetave e kanë bizneset që, ose e përdorin shtypin në shërbim të tyre, ose në shërbim të grupeve politike që kanë lidhje të ngushtë me bizneset e tyre.

“Ka ngacmime të Qeverisë ndaj medias të lirë e të pavarur” - thotë Raporti i BE-së. “Qeveria ka shtënë në varësinë e saj shtypin e shkruar dhe median elektronike” - thonë Raporti i Departamentit të Shtetit dhe Amnesty International. “Në Shqipëri shtypi nuk është i lirë për shkak të ndërhyrjes nga ana e shtetit”, - u tha së fundi në Raportin e OSBE-së. Pra, ka kohë që këmbanat po bien për ne këtu në Parlament dhe për të gjithë shqiptarët. Po rendis disa nga shkaqet pse ndodh kështu:

1. Kryeministri i përdor organet tatimore dhe fiskale për të bërë presion dhe për të nënshtruar mjetet e informimit publik. Ndërkohë asnjë përpjekje e këtyre organeve ndaj punës së zezë të gazetarëve, që tregon nivelin e ulët të standardeve në të gjitha mjetet e informimit tonë publik.

2. Kryeqeveritarët socialistë kanë përdorur dhe përdorin paret e shqiptarëve nëpërmjet reklamave, për të blerë shtypin dhe për të falimentuar atë pjesë të tij që nuk i nënshtrohet interesave të tyre.

3. Po për këtë qëllim, kryeqeveritarët socialistë dhe tjerë, si Kryetari i Bashkisë së Tiranës, përdorin fonde publike për të subvencionuar shtypin që të këndojë sipas muzikës së tyre.

4. Por për këtë qëllim, pra, nënshtrimin e shtypit, kryeqeveritarët socialistë u japin me preferencë tendera shumëmilionëshe atyre firmave ndërtuese që kanë pronësi edhe në mediat.

5. Dhe se fundi, për “të pabindurit” kanë dalë në modë proceset gjyqësore që synojnë falimentimin e shtypit të pavarur dhe opozitar dhe burgosjen e

përfaqësuesve të tij. Në këtë rast, pyetja që lind është se “a kemi të bëjmë me një cënim real të dinjitetit të paditësve, në rastin tonë të pushtetarëve, që me anë të mekanizmit ligjor synojnë rivendosjen në vend të tij, apo kjo dukuri përfaqëson unisonin e pushtetit të korruptuar kundër shtypit të lirë e fjalës të lirë?” Objekti i padive civile e penale, me anën e të cilave pushtetarët pretendojnë se ndjehen të cënuar, ka lidhje vetëm me aferat korruptive dhe lidhjet e pushtetit me to. Pra, shtypi ka vënë në shënjestër këtë dukuri erozive të shoqërisë shqiptare, e cila nuk mund të ekzistojë dhe të funksionojë pa infrastrukturën e tij, që në çdo shoqëri përkon me organet vendimmarrëse, pra, me pushtetin dhe me persona konkretë, që janë pushtetarët.

Zoti Kryetar, dëshiroj t’i përgjigjem pyetjes: A e ka vullnetin mazhoranca aktuale që të kemi mjete të informimit publik të lira dhe të pavarura?

- Unë them, gjithashtu, *jo*, sepse KKRT-ja vazhdon të jetë një instrument politik i mazhorancës që është bërë mbrojtëse e antiligjit. Unë do ta quaja thjesht spektakël atë pazar që bëri para ca kohësh Kryeministri me pronarët e disa prej mediave më të fuqishme dhe do e quaja më shumë se servilizëm qëndrimin e Kryetarit të Komisionit dhe të Kryetarit të KKRT-së, që nuk e informuan Kryeministrin se ato që kërkoheshin të amendoreshin ishin në ligjin ekzistues. Është domosdoshmëri rikompozimi i KKRT-së sipas ligjit dhe ky është thjesht vullnet politik i mazhorancës.

- Unë them se *jo*, përderisa nuk jepet urdhëri politik nga ana e mazhorancës për të hartuar ligjin për shtypin.

- Unë them se *jo*, përderisa nuk hartohet ligji për të drejtën e autorit, tashmë që ne i kemi nënshkruar të gjitha konvenat ndërkombëtare.

- Unë them se *jo*, përderisa që para dy muajsh si Komision duhej t’i paraqisnim Kuvendit listën e kandidaturave të KD të RTSH-së.

Me këtë mbrojtje nga pushteti, kuptohet se sa i lirë dhe i pavarur është ai shtyp që iu vërsul aq ashpër Ambasadorit të OSBE për një të vërtetë që ne e përjetojmë çdo ditë dhe sa ironike tingëllojnë fjalët e pushtetarëve për integrimin europian të vendit.

*Preç Zogaj
Deputet*

Rezultatet e monitorimit të lajmeve kryesore televizive kombëtare për muajin prill 2003 japin një pasqyrë mjaft shqetësuese të pabarazisë në shpërdarjen e kohës televizive. Në TVSH, minutazhi për Qeverinë, Kryeministrin dhe partitë e koalicionit qeveritar është rreth katër herë më i madh se minutazhi që u është dhënë partive të opozitës. Në TV Klan, ky raport është 3 me 1 në favor të mazhorancës, ndersa në TV Arbëria, që tashmë komportohet si një motërz e Televizionit Publik, raporti është 4,5 me 1 në favor të partisë në pushtet. Ndër subjektet e mazhorancës, konsumatori më i madh i kohës në TV Arbëria është Kryeministri Fatos Nano. Paradoksalisht, koha e Kryeministrit matet dhe raportohet veçmas nga koha e Qeverisë. Po ashtu, koha e PS-së dhe e partive të tjera të koalicionit qeveritar matet dhe raportohet veçmas nga koha e Nanos dhe e kabinetit të tij, megjithëse Kryeministri, Qeveria dhe partitë e qendrës së majtë janë pjesë e të njëjtit unitet politik. Kuptohet qartë se pasqyrimi veç e veç i këtyre pjesëve në buletinin e KKRT-së ka për qëllim të mjegullojë e të fshehë sadopak realitetin e papranueshëm të shpërdarjes së kohës televizive në emisionet e lajmeve.

Situata është shqetësuese sidomos në RTSH. Po të ishte korrespondent i BCC-së ose i Radios Radikale në Itali, drejtori i RTSH-së, Artur Zheji do të tundte fort krifën e flokëve dhe do të denonconte i pari shkeljen e rëndë në të vetmin televizion publik të Shqipërisë të parimit të njohur të *par condition* (kushteve të barabarta) në këtë media.

Gjatë muajit maj, pas reagimeve të deputetëve të opozitës, ka pasur një përmirësim të lehtë të treguesve, megjithëse situata është ende shumë larg standardeve. Konkretisht, në edicionet e lajmeve të TVSH-së mazhoranca ka marrë rreth pesëdhjetë përqind të kohës, kurse opozita njezet e tre përqind të kohës; në TV Arbëria mazhoranca ka marrë 48,2 për qind, kurse opozita 16,5 përqind; në TV Klan mazhoranca ka marrë rreth 50 për qind të kohës, kurse opozita 20,3 për qind.

Këto shifra i referohen monitorimit të lajmeve, por nëse do të monitoroheshin edhe tribunat politike ose specialet, që pasojnë edicionet e lajmeve, shpërpjesëtimi do të ishte shumë i madh.

Ku jemi këtu? Në cilin vend të Europës ndodh kjo? Është e vështirë për ne të pohojmë se kjo tablo ka lidhje me përkatësitë partiake të drejtuesve ose pronarëve të mediave audiovizive kombëtare. Ne i njohim pak a shumë pozicionet e tyre politike. Nga ana tjetër, dhe partiakët më të thekur do të ishin më të vëmendshëm e më të hapur në zbatimin e parimit universal të kushteve të barabarta në media. Shpërpjesëtimi i madh, si ai që pasqyrohet në buletinet e KKRT-së, shpjegohet me presionin politik dhe ekonomik që ushtron Qeveria mbi këto media. Drejtuesit kryesorë të RTSH-së e konsiderojnë veten emërtesa të Qeverisë dhe të Partisë Socialiste. Ata mendojnë se favorizimi i mazhorancës në median e vetme publike në vend është jo vetëm një shpërblim për këtë mazhorancë, por edhe një kusht për ruajtjen e postit ose vendit të punës. Në këtë çast nuk mund të flitet më për profesionalizim, për pavarësi. Këta drejtues harrojnë se pasi janë zgjedhur ose emëruar nga një shumicë e caktuar, duhet të kenë si busull vetëm ligjin. Në fakt nuk harrojnë. Qeveria i lejon ta shkelin ligjin. Qeveria ka koncepte propagandistike për median. Ajo i zgjedh drejtuesit e RTSH-së mbi bazën e këtij koncepti, pra, nuk kërkon profesionistë, por shërbëtorë. Qeveria pranon pa fjalë, madje kënaqet që merr për vete katër herë më shumë kohë se opozita. Qeveria është përgjegjësjë kryesore për gjendjen.

Në mediat private ndryshon puna. Siç e kanë vënë në dukje kolegët e

tjerë deputetë të opozitës, presioni mbi këto media realizohet nepërmjet levës ekonomike, nepërmjet favoreve me reklama shtetërore, me tendera, me licensime dhe në veprimtaritë tregtare që ushtrojnë pronarët e këtyre mediave. Në këtë rast liria e shtypit është vazhdimisht e kërcënuar, e programuar nga Qeveria. Dhe s'mund të ndodhë ndryshe kur leku vjen ose nuk vjen, falë vullnetit të Qeverisë.

Në vend të “sistemit të privilegjeve” që zbaton Qeveria socialiste, ne kemi propozuar një sistem rregullash të barabarta për të gjithë operatorët televizivë. Mendojnë se ky është rregulli i vetëm për të garantuar lirinë dhe barazinë në media.

Por edhe tani, legjislacioni ynë ka disa dispozita të përgjithshme që do të duhej të rregullonin problemet e barazisë së kushteve. Neni 36 i ligjit “Për Radiotelevizionin” ka të fiksuar nocionin e “paanshmërisë”. Në nenin 41, që flet për lajmet, thuhet se mediat “nuk i shërbejnë në mënyrë të njëanshme interesave të asnjë partie ose organizate politike”. Këto dispozita, megjithëse të përgjithshme, janë të mjaftueshme që KKRT të mos mjaftohet vetëm me konstatimin e gjendjes, por edhe me marrjen e masave. Nga ana tjetër, ka ardhur koha që ligji të shprehet me qartë për parimin e kushteve të barabarta. Thënë ndryshe, dispozitat që zbatohen në fushatën zgjedhore duhet të zbatohen përgjatë gjithë kohës.

Përafrimi i legjislacionit shqiptar me legjislacionin komunitar – proces vendimtar për integrimin europian*

*Ledi Bianku
Qendra Europiane*

Objektivat kryesorë të strategjisë së përafrimit janë:

- Dhënia e ndihmës për të krijuar një kuadër ligjor që të lejojë shndërrimin nga një ekonomi shtetërore në një ekonomi tregu.
- Përgatitja graduale e vendeve të asociuara për një integrim ligjor me Komunitetin Europian, duke identifikuar edhe sektorët jetikë, ku integrimi është i nevojshëm. Në këtë drejtim, strategjia e përafrimit të legjislacionit përbën një fazë thelbësore në përgatitjen e këtyre vendeve, qoftë hap pas hapi në asociim, qoftë dhe në vijim për anëtarësim.

Përafrimi i legjislacionit të vendeve të asociuara me legjislacionin e zbatueshëm në BE kërkohet në vetë marrëveshjet e asociimit (qoftë në ato europiane me vendet që janë futur në fazën e negocimit të aderimit tashmë, qoftë në marrëveshjet e stabilizim-asociimit) në përmbushje të disa qëllimeve:

- Në afat të shkurtër, për të shoqëruar tranzicionin në një ekonomi tregu, duke përfshirë krijimin e një kuadri ligjor që të lehtësojë investimet e huaja.
- Në një afat të gjatë, për të përgatitur aderimin e tyre në tregun unik. Për më tepër, tradita ligjore e vendeve të asociuara, pra, edhe e Shqipërisë,

* Vijon nga numri paraardhës.

duhet të shndërrohet dhe të mos ketë asgjë të përbashkët me atë të ekonomive të komanduara.

Duke iu referuar rëndësisë së përcaktimit të sektorëve më të rëndësishëm, ku duhet të konsistojë procesi i përafrimit të legjislacionit, Komisioni, në vijim të një kërkesë nga ana e Këshillit Europian, ndërmori një hap të rëndësishëm në maj të vitit 1995, duke nxjerrë Librin e Bardhë “që ofron një guidë për të ndihmuar vendet e asociuara në përgatitjen e tyre për të vepruar në përputhje me kërkesat e tregut të brendshëm të Bashkimit Europian.”

Libri i Bardhë identifikon masat kyçe në secilin sektor të tregut të përbashkët. Për këtë qëllim ai ofron një inventar prej afro 450 faqesh, që shërbejnë si guidë për vënien në jetë të rekomandimeve të Komisionit. Libri i Bardhë sugjeron, gjithashtu, radhën që duhet të ndjekë procesi i përafrimit të legjislacionit. Kjo radhë bën një dallim ndërmjet masave të fazës së parë, të cilat parashikojnë krijimin e një kuadri për një legjislacion më të detajuar, duke parashikuar parimet themelore dhe procedurat bazë dhe që përbëjnë një parakusht për funksionimin efektiv të tregut të brendshëm, nga njëra anë, dhe masave më të përparura, nga ana tjetër. Duhet theksuar qartë se një transportim i thjeshtë i legjislacionit komunitar nuk mjafton për të arritur pasojat e kërkuara, por duhen krijuar dhe vënë në lëvizje strukturat dhe procedurat për vënien në jetë dhe zbatimin e tyre. Është, gjithashtu, e rëndësishme të vlerësohet se vendet e asociuara janë përgjegjëse kryesisht për ritmet e tyre dhe se ato do të duhet që në këtë proces të përcaktojnë vetë përparësitë e tyre.

Libri i Bardhë shpall, gjithashtu, krijimin e një zyre të re informacioni për ndihmë teknike të administruar nga Komisioni. Kjo zyrë përmban një bazë të dhënash në lidhje me tregun e brendshëm dhe shërben si qendër për t’iu përgjigjur kërkesave për ndihmesë, këshilla dhe ekspertizë brenda Bashkimit Europian.

Është fare e qartë, gjithashtu, që Libri i Bardhë përqendrohet në masat që krijojnë dhe ruajnë tregun e brendshëm, ndërkohë që aderimi i vendeve të

reja do të nënkuptojë pranim dhe përafrim me tërësinë e *acquis communautaire*. Është për t'u vënë në dukje edhe fakti që Libri i Bardhë e trajton hapur në mënyra të ndryshme atë pjesë të *acquis communautaire* që ka të bëjë me qarkullimin e lirë të personave, përderisa kjo ka të bëjë me kushtet e lëvizjes së shtetasve të shteteve të tjera anëtare ose, siç quhen, edhe qytetarëve europianë.

Fushat në të cilat duhet të konsistojë procesi i përafrimit të legjislacionit sipas Librit të Bardhë janë përfshirë në Aneksin I të këtij artikulli.

Duke marrë si shembull Marrëveshjet e Stabilizim-Asociimit me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe me Kroacinë, duket se përparësitë e përafrimit të legjislacionit konsistojnë fushat e konkurrencës, të pronësisë intelektuale, të legjislacionit në fushat e çertifikimit dhe standardeve, të legjislacionit në fushat e prokurimit publik, si dhe mbi mbrojtjen e të dhënave¹. Këto janë zërat e tregut që përbëjnë objekt të afateve të posaçme, duke synuar edhe integrimin e tregut, së pari, në këto fusha nën vlerësimin e tyre, me sa duket, si më themeloret për krijimin e një tregu të përbashkët edhe në fushat e mbetura.

Përsa i përket konkurrencës, dispozitat për vënien në zbatim të rregullave komunitare në këtë sektor do të duhet të zbatohen brenda pesë vjetëve² pas hyrjes në fuqi të marrëveshjeve të stabilizim-asociimit. Sidoqoftë, në këtë sektor duket një përjashtim shumë i rëndësishëm që konsiston në rregulla specifike, ashtu si edhe në Traktatin e KE-së në fakt, përsa i përket çështjes së ndihmave publike. Në lidhje me këto ndihma, ky afat është katër vjet nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Stabilizim -Asociimit. Kjo gjë mund të jetë e

¹ Nderkohë që përgjithësisht në marrëveshjet europiane si përparësi figuronin rregullat e konkurrencës, ato të pronësisë intelektuale dhe rregullat në fushën e transportit. Shih: Van Den Bempt dhe Theelen.

² Shih nenin 69 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

rëndësishme, sidomos në lidhje me rastet dhe procedurat antidumping ose për të përcaktuar nëse disa produkte përfitojnë nga ndihmat shtetërore.

Për herë të parë parimet themelore të së drejtës materiale të konkurrencës i gjejmë në marrëveshjet europiane, duke qenë se në këto marrëveshje ato janë përfshirë ashtu siç parashikohen nga nenet 81, 82 dhe 87³ të Traktatit të Romës. Duke vlerësuar se ishte një detyrë e vështirë për vendet që kishin Marrëveshje Europiane zbatimi i kriterëve dhe parimeve të Komunitetit European në lidhje me konkurrencën, kjo duket se do të jetë e vështirë edhe për vendet që kanë ose do të kenë marrëveshje stabilizim-asociimi me KE-në e, në këtë drejtim, shenjat e para po duken nga ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Kroacia.

Në marrëveshje parashikohet që Këshilli i Asociimit duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për vënien në zbatim të këtyre kërkesave brenda periudhave që do të përcaktohen shprehimisht prej tij. Kjo nënkupton, nga ana tjetër, që dispozita të tilla, në qoftë se do të ngelen po në të njëjtën formë edhe në Marrëveshjen e Stabilizim -Asociimit me Shqipërinë, nuk do të kenë efekt të drejtpërdrejtë. Sidoqoftë, do të mund të gjejnë gjithmonë zbatim rregullat e përcaktuara nga jurisprudenca Woodpulp⁴. Ndërsa ndihmat shtetërore do të analizohen nën dritën e zbatimit dhe interpretimit të Nenit 87 të Traktatit KE-së

Në kuadrin e MSA-së, Shteti i asociuar duhet të adoptojë progresivisht legjislacionin teknik komunitar, si dhe procedurat europiane të rregullimit, të metrologjisë, të akreditimit dhe të vlerësimit të përputhjes së produkteve të tregëtuara me kërkesat esenciale të shëndetit publik dhe të sigurisë së konsumatorit, si dhe të nënshkruajë protokolle europiane për vlerësimin e produkteve⁵. Këto janë masa të domosdoshme për të siguruar lirinë e

³ Ish-nenet 85, 86 dhe 92 deri përpara hyrjes në fuqi të Traktatit të Amsterdimit.

⁴ Çështjet 89, 104, 114, 116, 117 dhe 125-129/85, 1988 ECR 5193.

⁵ Neni 73 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Maqedoninë.

qarkullimit të mallrave⁶. Gjithashtu, shteti i asociuar duhet të inkurajojë zhvillimin e infrastrukturave me cilësi dhe pjesëmarrjen në punimet e organizatave të specializuara. Por veçoritë teknike, të cilat fillimisht janë kombëtare, nuk duhet të bëhen pengesë për shkëmbimet, kështu që mënjanimi i këtyre pengesave arrihet me anë të përputhjes së këtyre normave me ato europiane. Për këtë, autoritetet komunitare kanë ndërmarrë harmonizimin e karakteristikave teknike të produkteve, duke ftuar kështu organizmat europianë të normalizimit për të përpunuar veçoritë teknike të nevojshme.

Pronësia intelektuale, industriale dhe tregtare duket se do të mbrohet brenda një afati të caktuar, duke përfshirë në termin *mbrojtje* jo vetëm daljen e akteve normative përkatëse, por edhe mjetet efektive për vënien e tyre në zbatim. I njëjti konceptim i termit *mbrojtje* natyrisht që vlen edhe për fushat e tjera në të cilat legjislacioni synohet të përafrohet dhe të ofrojë të njëjtën ‘mbrojtje’ me atë komunitare⁷.

Përafrimi në fushën e transportit, gjithashtu, mund të jetë i domosdoshëm, me qëllim që të mund të lehtësojë liberalizimin dhe aksesin e ndërsjellë në tregje të partnerëve nga vendet brenda tregut të përbashkët që do krijohet.

Përafrimi në sektorë të tjerë të tregut të brendshëm përbën një detyrim që duhet përmbushur në përfundim të periudhës tranzitore.

Ndërsa në fusha të tjera përafrimi mund të jetë më gradual, duke pasur parasysh, gjithashtu, shkallën më të madhe të vështirësive teknike dhe situatën konkurruese të ndërtimit të një ekonomie tregu. Këto fusha mund të përfshijnë legjislacionin në fushën e doganave, drejtën bankare, të tatimit të shoqërive tregtare dhe të kontabilitetit, legjislacionin për mbrojtjen e punëtorëve në vendet e punës, për shërbimet financiare, për mbrojtjen e konsumatorit, për

⁶ Boulin P., “La normalisation dans la construction européenne”, Revue des Affaires Européennes, 1991, n.4

⁷ Shih për shembull paragrafin 3 të nenit 68 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Maqedoninë.

mjedisin, për tatimet indirekte, për standardet teknike dhe legjislacionin në fushën e shëndetit.

Çështja e lëvizjes së lirë të punëtorëve duket se ngelet tepër delikate në këto faza të marrëdhënieve, ashtu siç ka qenë edhe për vendet e tjera të asociuara brenda periudhës së parë kalimtare dhe prandaj duket se nuk do të ketë punë të veçantë për përafrimin e legjislacionit të këtë fushë. Marrëveshjet veç sa u akordojnë një trajtim kombëtar⁸ punëtorëve nga shtetet e asociuara, të cilët janë vendosur ligjërisht në territorin e shteteve anëtare përsa i përket kushteve të punës, pagesës ose largimit nga puna.

Dispozitat në lidhje me lirinë e qëndrimit dhe të vendosjes mund të vlerësohen si më thelbësore. Në marrëveshjet e stabilizim-asociimit parashikohet që trajtimi kombëtar do t'u akordohet shoqërive tregtare dhe shtetasve të shteteve të vendeve të asociuara⁹.

Këshilli i Asociimit është i ngarkuar për të ndërmarrë nisma në lidhje me njohjen e diplomave dhe specializimeve të ngjashme, ndërsa ofrimi i shërbimeve mendohet që të liberalizohet në mënyrë progresive. Marrëveshjet përmbajnë, gjithashtu, dispozita që kanë të bëjnë me liberalizimin e pagesave dhe lëvizjen e kapitaleve për investime.

Trajtimi i të huajve, dhe sidomos i shtetasve të vendeve anëtare të Komunitetit Europian, është një çështje e rëndësishme në këtë kuadër, duke pasur parasysh faktin se privatizimi efektiv ka padyshim nevojë për angazhimin e kapitalit të huaj, me qëllim që të arrihet një zhvillim ekonomik i frytshëm. Në qoftë se me hyrjen e qytetarëve¹⁰ europianë në Shqipëri mund

⁸ Me trajtim kombëtar të një personi, në këtë rast të punëtorëve nga vendet e asociuara, do të kuptohet një trajtim i njëjtë me trajtimin që iu jepet punëtorëve me shtetësi të njërit prej shteteve anëtare të BE-së, me përjashtim të disa sektorëve të punësimit, sidomos me karakter publik, ku punësimi i këtyre punëtorëve mbetet kompetencë shtetërore.

⁹ Kjo gjë ishte parashikuar në fakt për herë të parë në Marrëveshjet Europiane.

¹⁰ Shih nenet 17-22 të Traktatit të KE-së.

të thuhet se kjo ndikohet nga tiparet e liberalizimit, ndonëse jo të plotë¹¹, për qëndrimin, kriteret janë më strikte.

Sidoqoftë, duke pasur parasysh sa thamë më lart në lidhje me qëllimet e procesit të përafrimit, duhet rikujtuar se ky proces nuk është qëllim në vetvete në procesin e integritit, por përbën një instrument të rëndësishëm për krijimin e një ekonomie tregu (në afat të shkurtër) dhe të integritit në tregun unik (në afat të gjatë). Në këtë kuadër duhet vlerësuar përparësia e adoptimit të një politikë të kujdesshme të një përafrimi vullnetar pozitiv, e cila do të mbante parasysh interesat e forcimit të tregut shqiptar përpara hapjes së plotë të tregut me KE-në dhe, duke përfituar nga karakteri asimetrik i marrëveshjes së stabilizim-asociimit¹², mund të çonte në përafrimin e legjislacionit edhe në disa nga këto fusha të renditura së fundi, ku mendja mund të na shkonte tek legjislacioni në fushën e standardeve, të shërbimeve financiare, të mjedisit ose të shëndetit.

KUADRI INSTITUCIONAL DHE NDRYSHIMET E NEVOJSHME

Që në vitin 1999 u krijua pranë Ministrisë së Shtetit për Reformën Legjislative dhe Institucionale, Drejtoria e Përafrimit të Legjislacionit Shqiptar me *acquis communautaire*. Krijimi i kësaj Drejtorie shënoi një hap shumë të rëndësishëm përpara në procesin e përafrimit. Megjithatë, suksesi i punës së saj u pengua nga disa faktorë. Së pari, një faktor përcaktues ishte orientimi i punës së zyrës me urgjencë normative, që nuk kishin të bënin fare me përparësitë e Librit të Bardhë, por me përparësitë e administratës dhe politikës shqiptare. Së dyti, Drejtoria e Përafrimit kishte mangësi përsa i përket stafit

¹¹ Me liberalizim të plotë natyrisht do të nënkuptonim edhe heqjen e çdo detyrimi formal - viza dhe pagesat përkatëse.

¹² Megjithëse një gjë e tillë mund edhe të vlerësohet shumë e maksimaliste në pretendime, të paktën për disa sektorë të tregut ose për disa produkte kjo edhe mund të jetë e realizueshme, në bazë të një politike të qartë ekonomike.

të paplotësuar si në numër, ashtu edhe në përgatitjen e duhur për këtë proces, nga njëra anë, ashtu edhe përsa i përket mundësive objektive për trajnimin e tij specifik. Kushtet profesionale të punës kanë qenë dhe, për fat të keq, janë ende larg nevojave të një sektori të tillë. Kalimi i kësaj Drejtorie në vijim pranë Zëvendëskryeministrit e vështirësoi problematikën, për shkak se në një nivel të tillë dhe në periudhën përkatëse, ngarkesa politike e punës së administratës shtetërore ishte shtuar, si dhe për shkak se kjo Drejtori nuk kishte arritur ende të futej siç duhej në shinat e punës së vet.

Në vitin 2000, Drejtorja e Përafrimit u kalua pranë Ministrisë së Drejtësisë me synimin për të qenë më afër procesit të kodifikimit të legjislacionit shqiptar, proces i cili bashkërendohet pikërisht nga Drejtorja e Kodifikimit pranë kësaj Ministrie. Ky pozicion i ri është formalizuar me ligjin organik nr. 8678, datë 14.5.2001, ku thuhet se nëpërmjet Drejtërisë së Përafrimit të Legjislacionit ndjek dhe bashkërendon punët me institucionet e tjera për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të BE-së. Sidoqoftë, Drejtorja e Përafrimit trashëgoi problemet e folesë së saj paraardhëse strukturore dhe ende nuk ka arritur të plotësojë siç duhet radhët e saj, si dhe të përcaktojë një plan të bashkërenduar mirë strategjik me ministrinë e linjës. Pavarësisht nga dalja e urdhrin nr.26, datë 27.2.2001 “Për ngritjen e grupit të punës për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të BE-së” të Kryeministrit, përshtypja është se rezultatet në drejtim të përpunimit të strategjisë së përafrimit nuk janë ato të preferueshmet.

Krijimi i institucionit të Ministrit të Shtetit për Integrimin Europian në shtator 2001, përveç amplifikimit dhe përforsimit të procesit nga njëra anë, sidomos e bashkërendimit të politikave, nga ana tjetër – e përafrimit të legjislacionit - dha përshtypjen e një vështirësimi të mëtejshëm të procesit. Kjo për arsyen se, ndërsa Ministrit të Integrimin iu ngarkua detyra e bashkërendimit të politikave në kuadrin e integrimin europian, dukej se Drejtorja e Përafrimit të Legjislacionit Shqiptar me atë të BE-së ngelej jashtë procesit, qoftë të bashkërendimit ligjor-përafrues të politikave të ministrive

të linjës, qoftë edhe përsa i përket procesit të përafrimit të legjislacionit edhe kur nisma normative nuk vinte në kuadrin e integritit europian. Në rastin e parë, për shkak se nuk bënte pjesë në strukturën bashkërenduese të politikave integruese – Ministrin e Shtetit për Integrimin Europian – së dyti, sepse skema ekzistuese në kuadrin e procesit të kodifikimit të legjislacionit nuk funksiononte siç duhej, për shkak të mangësive konceptuale, intelektuale dhe logjistike në lidhje me procesin.

Në një situatë të tillë do të ishte e pëlqyeshme, për mendimin tim, një përfshirje e Drejtorisë së Përafrimit të Legjislacionit në strukturën e Ministrisë së Shtetit për Integrimin Europian. Nga pikëpamja formale një lëvizje e tillë do të bënte të mundur që, nga njëra anë, aspekti politik i integritit të shoqërohej, të fuqizohej dhe të konkretizohej me veshjen juridike të përafuar dhe “çertifikuar” europiane. Nga ana tjetër, kjo do të mundësonte edhe frymëzimin, arsyetimin dhe shtysën politike të procesit normativ – integrues, duke i krijuar edhe mbështetjen e veçantë dhe të rëndësishme të dorës së parë këtij procesi. Sidoqoftë, duhet të jetë e qartë që ndryshimet strukturore, aq më tepër të një distance të tillë dikasteriale, nuk janë as qëllimi në vetvete dhe as nuk mund të kenë sukses, të para vetëm në suazën e vet. Ndryshimet strukturore jo vetëm që duhet të shoqërohen, por duhet të jenë edhe instrumenti mbështetës i një procesi të mirideuar – ajo ç’ka duket se i mungon ende procesit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire*. Ky proces do të duhej, sipas mendimit tonë, të strukturohej rreth disa çasteve bazë, disa prej të cilave kanë filluar të vihen në jetë nga Departamenti i Përafrimit të Legjislacionit, por që nuk kanë arritur ta shprehin vlerën e tyre për shkak të mungesës të hapave vijuese që do të realizonin konkretizimin e tyre. Këto çaste do të mund të konsistojnë në:

➤ krijimin e një baze të dhënash të strukturuar në lidhje me *acquis communautaire* dhe në veçanti me fushat e këtij të përcaktuara në Librin e Bardhë të Komisionit Europian të vitit 1995, duke përfshirë në këtë bazë të dhënash të gjithë elementet përbërëse të *acquis communautaire*;

➤ krijimin e një sistemi të qartë dhe të shkathët krahasimor të legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire* në mënyrë që të mund të arrihet shpejt dhe qartë në vlerësimin e pozicioneve dhe të zgjidhjeve normative shqiptare dhe komunitare në fusha të caktuara;

➤ përcaktimin e qartë të përparësive në kuadrin e përafrimit të legjislacionit, në afat të shkurtër, të mesëm dhe të gjatë, në përputhje me Librin e Bardhë të Komisioni European të vitit 1995 dhe me Planin Strategjik të Qeverisë Shqiptare të majit 2002, por edhe me përparësi të ideuara dhe të miratuara në lidhje me një integrim konkurrencial të Shqipërisë në tregun european në fushat ku një gjë e tillë është e mundur, si dhe me përparësi që mbajnë parasysh kriteret e nenit 31 (*ish-neni 36*) të Traktatit të KE-së;

➤ përcaktimin e teknikave dhe metodologjive të përafrimit të legjislacionit¹³, duke pasur parasysh në mënyrë të veçantë “*new approach*”, të parashtruar me Librin e Bardhë të Komisionit European të vitit 1985, si dhe jurisprudencat e GJED *Dassonville*, *Cassis de Dijon* etj¹⁴, si dhe kërkesat cilësore në adoptimin e aktit;

➤ miratimin e ‘ligji komunitar’¹⁵ ose ‘për integrimin european’, me objekt ofrimin e kuadrit ligjor të procesit përafrues, i cili të parashikojë jo vetëm rregullimin institucional dhe strukturor, por edhe procedurën e propozimit të akteve normative dhe të kontrollit të tyre nga Drejtoria e Përafrimit të Legjislacionit. Kjo e fundit do të duhet që t’i organizojë strukturat dhe funksionimin e vet në mënyrë të tillë që të jetë e pranishme për të dhënë mendimin e vet qoftë pranë ekzekutivit, qoftë pranë

¹³ Të cilat kanë filluar të përpunohen nga Drejtoria e Përafrimit të Legjislacionit.

¹⁴ Shih në lidhje me këtë teknikë, për shembull, N. Burrows “Harmonisation of technical standards: reculer pour mieux sauter?”, MLR – 1990.

¹⁵ Këtu mund të kihet parasysh, për shembull, situata italiane me ligjin komunitar ose të quajtur ndryshe La Pergola (emri i hartuesit të tij) i 9 marsit 1989.

Gjykatës Kushtetuese në raste më të veçanta¹⁶;

➤ parashikimin me ligj të detyrimit për dikasteret e linjës që, në përputhje me planet strategjike të vendosura nga Këshilli i Ministrave ose me programet e punës që dalin në zbatim të tyre nga Ministri i Shtetit për Integrimin, të përgatisin të gjitha projektaktet e kërkuara për procesin e përafrimit, duke respektuar kriteret cilësore të kërkuara nga përputhja me *acquis communautaire*;

➤ parashikimin e mundësisë që, mosmiratimi i një rregullimi të caktuar në përputhje me normativën e ndërsjellë komunitare nga ministria përkatëse ose nga Kuvendi, të pasohet, pas një periudhe që mund të ishte një vit¹⁷, me adoptimin normativ të aktit komunitar në të drejtën e brendshme.

PLANI I VEPRIMIT TË QEVERISË, ÇFARË KUPTOHET DHE AFATET KOHORE PËR NDRYSHIME

Në dhjetor të vitit të kaluar Këshilli i Ministrave paraqiti Planin e Veprimit për periudhën e Negocimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Ndonëse më 27 maj 2002 Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë paraqiti Planin Strategjik të Qeverisë Shqiptare për Integrimin European, që në përmbajtje përbën një dokument më të plotë sesa Plani i Veprimit i dhjetorit 2001 edhe për arsyen se përbën një thellim dhe detajim, por sidomos strukturim më të plotë dhe më strategjik të objektivave të të parit, Plani Strategjik nuk

¹⁶ Në prani të mundësisë së lindjes së situatave të parashikuara nga nenit 131, a) dhe b), dhe 122 të Kushtetutës.

¹⁷ Periudha një vit sugjerohet në fazën e negocimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ose të veprimit normativ të kësaj, duke pasur parasysh strukturën dhe afatet që ka nga një fazë të tjetra por në rastin e anëtarësimit të plotë ky afat mund të jetë i ndryshëm, duke pasur parasysh kriteret specifike të parashikuara nga direktiva (në këtë fazë të fundit përafrimi me rregulloret dhe me vendimet do të jetë problem e kapërcyer teorikisht për shkak të efektit të tyre të drejtpërdrejtë në bazë të nenit 249 të Traktatit të Romës).

ka marrë ende asnjë miratim formal nga ana e Këshillit të Ministrave, ndërkohë që Plani i Veprimit e ka kapërcyer këtë hap procedural. Ky çast, ndonëse nuk mund të thuhet që ka vlera përcaktuese, ndikon në mirecurinë e procesit të stabilizim-asociimit. Sidoqoftë, në të dyja Planet – atë të Veprimit dhe atë Strategjik, një nga përparësitë e parashikuara konsiston pikërisht në lidhje me përafrimin e legjislacionit. Megjithatë, duket se planet e Qeverisë në lidhje me përafrimin e legjislacionit konsistojnë kryesisht në aspektin “Stabilizim” të integritimit europian dhe fare pak në aspektin e tij “Asociim”. Në këtë përfundim mund të arrihet duke parë fushat në të cilat ndërmerret angazhimi për veprim përafres nga ana e Drejtorisë së Përafrimit. Duket se masat e menduara synojnë të kufizohen në aspekte të sistemit të drejtësisë dhe të rendit, dhe jo aq në sektorë të tjerë të *acquis communautaire*, që për më tepër janë parashikuar shprehimisht nga Libri i Bardhë i lartpërmendur. Ky orientim i mekanizmit përafres duket se arrin të krijojë kushtet paraprake për të hapur Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, por jo që të ofrojë kushtet më të përshtatshme për një negociim efektiv të marrëveshjes nga pala shqiptare, duke mos arritur të krijojë kuadrin ligjor të vendosjes së një tregu të lirë ndërmjet Komunitetit Europian, vendeve të tij anëtare dhe Shqipërisë. Mangësitë normative në këtë drejtim, si edhe i etapizimit të përshtatshëm të procesit, mund të ishin me pasoja të rënda për procesin e stabilizim-asociimit shqiptar, ashtu si edhe për qëllimin përfundimtar të integritimit të plotë të Shqipërisë në BE.¹⁸

Sidoqoftë, duhet thënë se Plani i Veprimit i Dhjetorit deri në një farë mase duket më konkret në drejtim të përafrimit të legjislacionit në fusha që kanë të bëjnë me *acquis* të tregut të përbashkët¹⁹, por që gjithsesi i mungon

¹⁸ Mjafton të kujtojmë këtu problemet e njohura të Polonisë në lidhje me politikën e përbashkët bujqësore të KE-së ose shtyrjen e procesit të integritimit për Rumaninë dhe Bullgarinë për shkak të vonësave të këtyre në realizimin e reformave, ndër të tjera edhe të asaj të përafrimit të legjislacionit.

vizioni i këtij procesi në një afat të mesëm dhe të gjatë, si dhe përshkrimi i procedurave dhe mjeteve që duhen përdorur në këtë proces.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Përfundimi në të cilin mund të arrihet në përmbyllje të analizës sonë është ai që strukturat shqiptare nuk janë ende në ritmin e duhur për plotësimin e objektivit madhor të përafrimit të legjislacionit me *acquis communautaire*. Me strukturat nuk duhet të kuptojmë vetëm Drejtorinë e Përafrimit të Legjislacionit për shkak se ajo për shkak të kapaciteteve në burime njerëzore dhe materiale është krejt e pafuqishme që e vetme ta përmbushë misionin që i është ngarkuar. Nga kjo pikëpamje, pra mungesa e mbështjetjes së Drejtorisë së Përafrimit edhe nga drejtori juridike ose sektorë juridikë në dikastere ose departamente të fushave që përfshihen specifikisht në *acquis*, përbën një mangësi themelore të procesit.

Nga ana tjetër duhet që puna të konsistojë në një program të strukturuar, të etapizuar dhe që respekton nivelet cilësore të adoptimit të akteve, duke pasur parasysh qëllimin – krijimin e një tregu të përbashkët.

Pra, në përfundim të analizës sonë, rekomandimet kryesore do të konsistonin në drejtimin struktural dhe në drejtimin strategjik. Në të dyja këto drejtime puna e sektorëve përkatës dhe sidomos e Drejtorisë së Përafrimit të Legjislacionit duhet të jetë më konsistente. Ndërsa nën këndvështrimin e parë, përfshirja e Drejtorisë së Përafrimit në strukturat e Ministrit të Shtetit për Integrimin Europian mund të duket si një zgjidhje, mosshoqërimi i kësaj

¹⁹ Plani i veprimit të Qeverisë i dhjetorit 2001 parashikon që procesi i përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire* do të konsistojë në fushat përkatëse: të drejtat e pronësisë intelektuale dhe industriale, qarkullimi i lirë i kapitaleve, konkurrenca dhe mbrojtja e konsumatorit, prokurimi publik, marrëdhëniet e punës dhe politikat sociale, standardizimi dhe certifikimi.

mase organizative me masa të tjera organike mund të bëjë që të mos arrihen rezultatet e pretenduara. Për këtë qëllim do duhet përgatitur një organogramë e qartë, strukturore, procedurale dhe metodike e cila të lejojë që i gjithë procesi normativ shqiptar të ketë një digë në të cilin të kontrollohet dhe përpunohet legjislati në analizë të fundit – atë të përafrimit me *acquis communautaire*. Në realizimin e këtyre rekomandimeve në fushat e lartpërmendura natyrisht që e pëlqyeshëm do të ishte që çasti struktural të vihej në shërbim të çastit strategjik të procesit, duke pasur parasysh me këtë marrëdhënie që konceptimi dhe funksionimi i strukturave përkatëse dhe sidomos të Drejtorisë së Përafrimit duhen vënë në shërbim të realizimit të strategjisë së përafrimit të legjislatit dhe të qëllimeve që ky proces ka, me qëllim që të krijohen premisat konkrete për një integrim kuptimplotë në tregun unik evropian.

Një konsideratë përfundimtare do të përcaktohej në faktin që përafrimi i legjislatit me *acquis communautaires* konsiston jo vetëm në abrogimin e dispozitave që bien në kundërshtim me rregullimet normative komunitare, po e shpreh vlerën e vet para së gjithash në ofrimin e një rregullimi të ngjashëm me atë komunitar dhe në ofrimin e zgjidhjeve që mundësojnë arritjen e qëllimeve të tregut unik. Pra, përafrimi i legjislatit nuk është vetëm një proces me karakter normativ negativ, në kuptimin e abrogimit të dispozitave të papërshtatshme, por merr kryesisht, dhe sidomos për situata si kjo e Shqipërisë, tiparet e një procesi me karakter pozitiv, pra të miratimit të akteve të brendshme që parashikojnë rregullime normative që çojnë në të njëjtin rezultat në të cilin synojnë të çojnë rregullimet normative komunitare.

ANEKS I

Sipas Librit të Bardhë të Komisionit Evropian i majit 1995 procesi i përafrimit të legjislatit duhet të konsistojë kryesisht në fushat e mëposhtme:

1. Lëvizja e lirë e kapitaleve
2. Qarkullimi i lirë dhe siguria e produkteve industriale
3. Konkurrenca
4. Politika dhe veprimtaria Sociale
5. Bujqësia
6. Transporti
7. Veprimtaria audiovizuale
8. Mjedisi
9. Telekomunikacioni
10. Tatimet direkte
11. Qarkullimi i lirë i personave
12. Prokurimi Publik
13. Shërbimet Financiare
14. Të dhënat personale
15. E drejta e shoqërive
16. Kontabiliteti
17. E drejta civile
18. Njohja e ndërsjellë e përgatitjeve profesionale
19. Pronësia Intelektuale
20. Energjia
21. Doganat dhe aksisat
22. Tatimet e tërthorta
23. Mbrojtja e Konsumatorit

Shqipëria dhe Europa: Perceptime dhe realitete

Raymond Detrez
Universiteti i Ghent-it, Belgjikë

Përktheu: Elira Zaka

Marrëdhëniet midis Europës dhe Shqipërisë janë tashmë një temë që ka tërhequr vëmendjen jo vetëm të shkencëtarëve në fushën e historisë dhe të politikës, por edhe të shkrimtarëve dhe artistëve për më shumë se dyqind vjet me radhë - në Europë dhe në Shqipëri. Këto marrëdhënie kanë konsistuar kryesisht në kontakte diplomatike, marrëdhënie tregtare, aleanca ushtarake, konflikte etj., por janë shfaqur, gjithashtu, në mënyrën e posaçme se si është perceptuar Shqipëria në Europë. Përfytyrimi i Shqipërisë mund të duket në pamje të pare se nuk ka asgjë të përbashkët me procesin e paimagjinueshëm të integritimit Europian dhe Euroatlantik. Sidoqoftë, mënyra jonë e perceptimit ose imagjinimit të një personi, një komuniteti, apo një vendi mund të influencojë thellësisht predispozicionin tonë kundrejt tyre dhe, si pasojë, edhe mënyrën e komunikimit me ta. Padyshim, perceptimi mbi Shqipërinë nuk mund të ndahet nga perceptimi për Ballkanin në përgjithësi, i cili ka tërhequr kohët e fundit vëmendjen e shume studjuesve¹.

¹ P.sh.. Bakia-Hayden, Milica. 'Nestling Orientalism: The Case of Former Yugoslavia'. *Slavic Review* 54 (1995), nr. 4, 917-931; Todorova, Maria. *Imagining the Balkans*. New York, Oxford: Oxford University Press, 1997; Goldsörthy, Vesna. *Inventing Ruretanian. The Imperialism of Imagination*. New Haven, London: Yale University Press, 1998.

Çështja nëse Ballkani i përket Europës ose jo është me sa duket tepër e ndërlikuar. Duket se mund të ketë problem me “Europeanizmin” e Ballkanit. Në fillim të viteve 90-të ishte një tendencë në Europën Perëndimore dhe në Shtetet e Bashkuara për të pranuar kombet e Europës Qendrore si krejtësisht Europiane, dhe të përjashtonin vendet e Ballkanit nga Europa – për arsye që kishin të bënin kryesisht me luftën në Jugosllavi. Në dritën e integritimit European, urrejtja etnike, nacionalizmi dhe separatizmi ishin shënjuar si tipare tërësisht jo- Europiane - sikur këto fenomene të kenë munguar në historinë e Europës. Prej shkujdesjes dhe injorancës, këto luftra, megjithëse shpërthyen tërësisht dhe vetëm brenda kufijve të Jugosllavisë, u quajtën shpesh nga gazetarët dhe politikanët “luftrat e Ballkanit”, sikur i gjithë Ballkani të ish përfshirë në to. Si rezultat, jo vetëm Jugosllavia, por i gjithë gadishulli u stigmatizua dhe iu mohua privilegji për t’u quajtur “European”. Si pasojë, dyert e institucioneve Europiane dhe veçanërisht të Bashkimit European për momentin mbetën të mbyllura. Mund të konsiderohet si ironia e historisë – apo ironi e zgjerimit European- që tani vende si Shqipëria, Bullgaria, dhe Rumania ka të ngjarë t’i bashkohen BE-së nëpërmjet Paktit të Stabilitetit për Europën Juglindore në një fazë më të hershme se ç’ ishte parashikuar, “falë” reputacionit të pamërituar si shkaktarë trazirash, që morën për shkak të Jugosllavisë. Në këtë rast, përsëri ata nuk pranohen, sepse, në fakt, konsiderohen kombe “Europiane”, por më tepër si një zgjidhje për Europeanizmin e tyre gjoja të munguar.

T’i përkasësh Europës mund të thotë shumë gjëra. Është një kriter i pastër gjeografik. Është kriteri i identitetit kulturor European, i traditave kulturore Europiane dhe vlerave Europiane.

Në këtë këndvështrim, “Europeanizmi” është diçka e ngjashme me një titull honorifik. Për më tepër, është Europa si një konstruksion politik, që përfshin një numër institucionesh, të cilat mund t’ju pranojnë ju si anëtarë ose jo, duke i bërë kështu të vlefshme për ju përfitimet nga anëtarësimi. Mund të jetë mikluese të konsiderohesh European në sensin kulturor, por

është shumë më tepër interesante të jesh European institucionalisht. Sidoqoftë, çdo kandidat-anëtar i institucioneve europiane është supozuar të fitojë së pari një identitet kulturor europian, të tregojë angazhimin kundrejt vlerave europiane, përpara se të bëhet i pranueshëm si anëtar formal i këtyre institucioneve.

Si të vlerësojmë pozicionin e Shqipërisë në dritën e interpretimeve të ndryshme mbi Europeanizmin? Le të konsiderojmë, duke filluar me faktin e vogël, por të rëndësishëm, se Shqipëria është pjesë e tërësisë gjeografike të quajtur Europë. Nëse Europa do të bashkohet në një strukturë të madhe, si federatë, duke u shtrirë pothuaj në të gjithë kontinentit, nuk ka asnjë mundësi që Shqipëria të lihet jashtë. Ashtu siç pohoi Romano Prodi në vizitën e tij në Tiranë, në janar 2003: “Ballkani është pjesë integrale e Europës dhe procesi i unifikimit të kontinentit tonë do të jetë i plotë vetëm kur vendet e Ballkanit të bëhen pjesë e Bashkimit”² .

Shqipëria ka një kufi të përbashkët me një nga vendet anëtare të BE-së, dhe është e ndarë nga një tjetër vend anëtar vetëm nga 70 km det. Ndërsa zgjerimi i Bashkimit European vazhdon, vendet e Ballkanit do të përfshihen në këtë process dhe është e pamendueshme që Shqipëria apo cilido nga vendet e Ballkanit të lihen jashtë, duke mbetur kështu si një ishull i vogël i një territori jo-europian brenda Bashkimit European. Edhe Zvicra, e cila për momentin preferon të mbetet jashtë Unionit, është e lidhur me BE-në në shumë mënyra dhe janë të gjitha gjasat që në përfundim të bëhet, gjithashtu, anëtare e BE-së. Më dyshuesit ndërmjet nesh mund ta quajnë këtë ekspansionizëm, por kjo mënyrë e përhithjes së territoreve të reja duket si një motiv historik, sipas të cilit zhvillohen formacione territoriale të mëdha si shtete, si BE-ja. Duket sikur kjo bëhet në të mirë të territoreve të interesuara.

²‘Albania’s European Destiny’. Fjalim nga Romano Prodi (http://europa.eu.int/comm/external_relations/news/prodi/spal03/htm).

A është Shqipëria – dhe e njëjta pyetje mund të shtrohet për të gjithë Ballkanin-pjesë e Europës nga këndvështrimi historik? A ka marrë pjesë Shqipëria dhe a ka kontribuar në zhvillimin dhe vendosjen e tërësisë historike që ne e quajmë sot Europë? Është pak ironike të flasësh për këtë fakt në afërsi të Durrësit- qyteti i cili i jep përgjigje kësaj pyetjeje. Në antikitet, Durrësi ishte një nga portet më të rëndësishme të Perandorisë Romake, i vendosur në *via Egnatia*, një nga arteriet kryesore të Perandorisë Romake që lidhte Romën me Kostandinopojën. Në atë kohë Durrësi ishte, siç edhe gërmimet arkeologjike dhe monumentet e lashta me bollëk demonstrojnë, një qendër e rëndësishme e civilizimit grek dhe romak. Qyteti zë një vend të veçantë në historinë e pushtimeve Normane, të cilët sunduan mbi Sicilinë dhe Italinë e Jugut dhe në historinë e Krusadëve. Ishte një nga portet kryesore të perandorisë detare të Venedikut. Me fjalë të tjera, historia e këtij qyteti është kaq ngushtë e lidhur me ngjarjet më të mëdha historike të Europës dhe zhvillimet, sa që nuk ka arsye për t'i mohuar një vend në Europë. Kjo vlen, gjithashtu, edhe për Vlorën, Korçën, Shkodrën, Gjirokastrën dhe qytete të tjera të Shqipërisë dhe, më së fundmi, për të gjithë vendin si një i tërë. Objeksioni i zakonshëm rreth europianizmit të Ballkanit dhe rrjedhimisht të Shqipërisë është se gadishulli u nda prej Europës si pasojë e pushtimit otoman i pasuar nga dominimi otoman që zgjati për rreth 5 shekuj. Kjo mënyrë tradicionale e të kuptuarit, e cila, në fakt, kufizon Europën nga Europa Qendrore dhe Perëndimore, vazhdon të jetë shumë popullore, jo vetëm në Europën Perëndimore, por edhe në Ballkanin vetë. Disa historianë bashkekohorë, sidoqofte, duke vënë mbi gjithçka eurocentricizmin tradicional dhe duke u mbështetur në një *approach* më global të historisë, por edhe të vetë Ballkanit, preferojnë ta shohin Europën vetëm si komponent të fushës ekonomike, politike dhe kulturore, të formuar prej Mesdheut dhe nga kjo perspektivë njohin plotësisht rolin e spikatur të Perandorisë Otomane në historinë europiane. Robert Matran, botues dhe bashkautor i një prej historive më mbizotëruese rreth Perandorisë Otomane, shkruajti: “Një histori e Europës,

një histori e botës së Mesdheut nuk do të ishte e plotë pa Perandorinë Otomane”³. Midis fuqive Europiane dhe Perandorisë Otomane kanë ekzistuar gjithmonë marrëdhënie diplomatike dhe tregtare normale, kanë pasur edhe periudha konflikti dhe rivaliteti, por edhe bashkëpunimi madje dhe admirimi, shkurt, të njëjtat marrëdhënie midis Perandorisë dhe vendeve Europiane si edhe midis vetë vendeve europiane. Në shekullin e 19-të, në mënyrë sinjifikative, Perandoria Otomane u quajt “I sëmuri.. i Europës”. Shqiptarët luajtën një rol të shquar në jetën politike dhe ushtarake të Perandorisë Otomane. Stavrianos ka vënë në dukje se nga dyzet e nëntë vezirë të periudhës 1453 – 1623, njëmbëdhjetë ishin shqiptarë, 11 ishin sllavo-jugorë, dhe vetëm pesë ishin turq(...). Po kështu, nga fundi i shekullit të nëntëmbëdhjetë, Abdul Hamid varej shumë nga shqiptarët, të cilëve u besonte më shumë se subjekteve të tjerë. Roja e Pallatit dhe Trupa e Parë e Ushtrisë, e cila ruante kryeqytetin, përbëhej kryesisht prej shqiptarësh⁴. Dhe të gjitha arritjet e këtyre njerëzve mund të konsiderohen pjesë e historisë europiane.

Me shumë domethënie, gjithashtu mund të konsiderohet periudha e Tanzimatit – periudhë e reformave në shkallë të gjerë, që synonte të transformonte Perandorinë në një monarki kushtetuese moderne. Është periudha e perëndizimit, gjatë së cilës në të gjithë perandorinë dhe veçanërisht në të gjithë Ballkanin Perëndimor u bë e njohur teknologjia perëndimore (si shërbimet telegrafike dhe hekurudhat), por edhe institucionet perëndimore si ministritë, arsimi publik, kujdesi shëndetësor publik etj., dhe së fundmi u adaptuan edhe sjelljet dhe vlerat perëndimore. Sigurisht që ekzistonte edhe një lëvizje e konsiderueshme opozitare kundër Tanzimatit e nisur nga kleri (si ai islamik, ashtu edhe ai kristian), si dhe nga lordët feudalë. Mund të vihet re se reformat u imponuan nga fuqitë Perëndimore dhe mund të ketë dyshime mbi sinqeritetin e klasës sunduese, që kryente të gjithë operacionin, por nuk

³ Mantran, Robert (ed.). *Histoire de l'Empire Ottoman*. Paris : Fayard, 1989, 12.

⁴ Stavrianos, L. S.. *The Balkans since 1453*. London: Hurst Company, 2000 [1958], 501.

mund të mohohet që Tanzimati në analizë të fundit kontribuoi në shfaqjen e një kategorie intelektualësh të orientuar nga perëndimi, të cilët ishin të etur për të prezantuar të rejat e Perëndimit dhe veçanërisht sistemin parlamentar perëndimor, të bindur se kjo do të ndihmonte në rritjen e mirëqënies dhe të demokracisë në vendin e tyre. Në Shqipëri, Naim, Mit'hat Frashëri dhe Faik Konica janë shembujt më të mirë të këtij tipi intelektualësh liberalë. Sidoqoftë, duke lexuar me vëmendje artikujt, pamfletet dhe librat e tyre, çdokush do të vinte re ata nuk konsideruan reformat që propozuan si prezantim të vlerave europiane krejtësisht të reja dhe të panjohura në një mjedis krejtësisht të papërgatitur dhe të prapambetur, por më tepër si aktivizim të vlerave bazë të demokracisë, të cilat kishin qenë gjithmonë të pranishme në kulturën e tyre tradicionale. Në shoqërinë ballkanase shqetësimi për edukim, drejtësi sociale, vetë-qeverisje demokratike nuk kishin munguar kurre dhe nuk ndryshonte thellësisht nga praktika europiano-perëndimore, pavarësisht nga kushtet krejtësisht të ndryshme e të pafavorshme, burimet dhe mundësitë. Perëndizimi i Ballkanit ishte një proces, i cili, faktikisht, vazhdoi, stimuloi dhe kanalizoi praktikat dhe aspiratat e ngulitura në shoqërinë ballkanase.

Megjithëse shqiptarët ishin të integruar shumë mirë në strukturat ekonomike, politike dhe ushtarake të Perandorisë Otomane, Shqipëria mbeti një vrimë e verbër në njohjen e Europës Perëndimore. Shumë gjeografë udhëtuan përmes vendit, por siç e ka theksuar dhe një prej tyre, Europa ishte më mirë e informuar për Afrikën e Zezë se sa për Shqipërinë. As malet e larta, as natyra gjoja e egër e banorëve të saj nuk ishin arsyet e kësaj injorance. Mungesa e njohjes dhe interesit për Shqipërinë u shkaktua së pari nga shfaqja relativisht e vonuar e një lëvizjeje kombëtare, duke shtyrë politikanët dhe gazetarët të njihen me “çështjen Shqipëri”. Për më tepër, nuk kishte ndonjë interes akademik për Shqipërinë dhe shqiptarët.

Filologët klasikë do të ishin të interesuar për gjuhën dhe kulturën moderne greke, dhe filologët sllavë, në vendet sllave të Ballkanit, por asnjë nga filologët tradicionalë do të nxisnin nxënësit e tyre që Shqipëria dhe shqiptarët të

bëheshin fusha e tyre e kërkimit. Sot ka pak universite, gjithashtu, ku mësohet shqipja, megjithëse ka përmirësime. Pas Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria u vetizolua nga pjesa tjetër e botës, duke kufizuar kontaktet e veta ndërkombëtare kryesisht me Bashkimin Sovjetik dhe më pas me Kinën. Kjo kontribuoi që Shqipëria të perceptohet edhe më shumë si një vend i mbyllur, i padepërtueshëm. Politika izoluese e Shqipërisë gjatë periudhës së komunizmit, kombinuar me injorancën në Perëndim, rezultoi në një perceptim perëndimor të Shqipërisë, të shënuar nga ajo që Mariella Panfolli e quajti folklorizëm apo ekzoticizëm të Shqipërisë.⁵ Sipas saj, veprimi i Shqipërisë në politikat ndërkombëtare dhe sjelljet e shqiptarëve vetë tentojnë të shpjegohen duke iu referuar sistematikisht folklorit ose duke u atribuar shqiptarëve një make-up psikologjik të veçantë e të pandryshueshëm ekzotik. Në vend që të investigojnë në kushtet aktuale politike, ekonomike dhe sociale, shumë “ekspertë” ende preferojnë të shtrojnë për diskutim mentalitetin gjoja luftarak dhe fisnor të shqiptarëve, duke treguar qindra-mijëra bunkerët, ose tek Kanuni i vjetër⁶. Karakteri kombëtar, sidoqoftë është gjithmonë një shpjegim sekondar dhe i ndërlikuar i ngjarjeve dhe zhvillimeve në shoqëri, ku mund t’i referohesh një morie kushtesh të matshme dhe bindëse. Në Shqipëri, sidoqoftë, stereotipet e vjetra esenciale, të gjeneruara nga injoranca, duken si veçanërisht të guximshme.

Paragjykimet dhe stereotipet rrallë përputhen. Për më tepër, në perceptimin e Shqipërisë si një kështjellë e vetmuar, është më kontradiktor perceptimi i

⁵ Pandolfi, Maria. ‘Myths and New Forms of Governance in Albania’. *Albanian Identities. Myth and History*. Edited by Stephanie Schëandner-Sievers and Bernd J. Fischer. London: Hurst & Company, 2002, 205.

⁶ Duke ofruar një botim shumë luksoz të *Kanunit* në anglisht, për turistët, librashitësit shqiptarë në mënyrë të pavullnetshme përforcuan perceptimin folkloristik të shqiptarëve tek të huajt (Gjeçov, Shtjefën. *Kanuni i Lekë Dukagjinit. The Code of Lekë Dukagjinit*. I përkthyer dhe me një hyrje nga Leonard Fox. New York: Gjonlekaj Publishing Company, 1989.)

Shqipërisë si një vend që varet nga ndërhyrja dhe mbështetja nga jashtë. Shqipëria u shpall shtet i pavarur në vitin 1912 gjatë Luftës Ballkanike, në kushte jashtëzakonisht të vështira dhe kaotike. Kjo ndodhi falë mbështetjes së Fuqive të Mëdha, të cilat i detyruan shtetet e Ballkanit ta pranonin pavarësinë e Shqipërisë. Për disa vite, Shqipëria u administrua nga të njëjtat fuqi. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Italia, Franca dhe Austria e copëtuan Shqipërinë. Në vitin 1939 Italia pushtoi Shqipërinë. Gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe vitet e para mbas saj, partia komuniste shqiptare ish dominuar gjerësisht prej komunistëve jugosllavë. Disa njerës janë të prirur për të parë një paralele midis ndërhyrjeve perëndimore pikërisht pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë dhe pranisë së tanishme të NATO-s dhe OSBE-së. Është me të vërtetë një histori e gjatë e ndërhyrjeve të huaja, por siç edhe janë paraqitur shpesh, jo gjithmonë ato i kanë shërbyer interesave të Shqipërisë, ato nuk tregojnë domosdoshmërisht varësinë e Shqipërisë prej tyre. Aktualisht, në disa raste ato na tregojnë më shumë rreth politikave të Fuqive të Mëdha dhe fqinjve të Shqipërisë, pastaj për mentalitetin e shqiptarëve.

Nëse izolimi, mosbesueshmëria, konservatorizmi patriarkal ishin kaq tipike për shqiptarët, saqë gjithkush do të habitej se si shqiptarët vazhduan pas më shumë se dyzet vjetësh diktature të ashpër totalitare dhe izolimi, t'i hapen kaq shpejt botës, të familjarizohen me arritjet teknologjike të shoqërisë moderne perëndimore dhe me standartet dhe rregullat ndërkombëtare të pranuar e të aplikuara që lidhen me ekonominë e tregut të lirë, demokracinë parlamentare, të drejtat e njeriut, etj.? Pandolfi shkruan sërish, duke komentuar mbi stereotipet për Shqipërinë dhe shqiptarët:

“Që shumë ndërhyrje perëndimore në Shqipëri janë ende të informuar nga stereotype të tilla që provojnë për fortësinë e përfaqësimeve esencialiste – pavarësisht nga fakti që shumë ekspertë civilë dhe ushtarakë që kanë punuar ose bashkëpunuar direkt me sektorë të shoqërisë shqiptare kanë qenë të impresionuar nga niveli i lartë arsimor, dhe njohja e gjuhëve të huaja

nga brezi i ri në Shqipëri, të cilët kanë fituar akses lehtësisht për të studiuar jashtë.”⁷

Në përgjithësi, vendet e ish- komuniste të Europës Lindore kanë arritur të kontrollojnë fatkeqësitë dramatike politike, ekonomike, sociale, madje edhe filozofike që shkencëtarët politikë e kanë quajtur, me një maturitet të admirueshëm, në mënyrë kaq eufemike “tranzicion”. Ata e arritën këtë në mënyrë jo edhe aq të dhunshme sa ç’ pritej, madje edhe në Shqipëri ku regjimi komunist ishte më i ashpër se kudo. Në një kohë shumë të shkurtër Shqipëria vazhdoi të kryente një sërë reformash politike dhe ekonomike, të kërkuara nga institucionet përkatëse europiane, anëtare e të cilave ajo aspiron të bëhet. Që prej 1991-shit Shqipëria bashkëpunon me Bashkimin Europian. Në të njëjtin vit Shqipëria u bashkua me OSBE-në. Më 1992 ajo firmosi një Marrëveshje Tregtare bashkëpunimi me Bashkimin Europian. Më 1994 Shqipëria firmosi Dokumentin e Programit për Paqen dhe Partneritetin. Më 1995 u bë anëtare e Këshillit të Europës. Që prej 1999-ës ajo merr pjesë në Procesin e Stabilizimit dhe Asociimit. Në vitin 2000 ajo u pranua bashkë me vende të tjera të SAP si një “kandidate e mundshme” për anëtarësim në BE. Në dhjetor 2001, Shqipëria bëhet anëtare e Organizatës Botërore të Tregtisë. Në 2001-shin fillon negociatat me Bashkimin Europian për Marrëveshjen e Asociimit dhe të Stabilizimit.

Shqipëria merr pjesë aktive në një sërë programesh ndërkombëtare dhe europiane, në operacione ushtarake etj. Kjo dëshirë dhe përpjekje për t’u integruar në institucionet europiane, në fakt, i rinis ambicjet politike të ndërtuesve të kombit dhe shtetit shqiptar të shekullit të 19-të në mënyrë më efektive, sesa izolimi frenetik gjatë periudhës totalitare, sadoqë regjimi komunist i quante “të tijtë”.

Sigurisht që ne nuk duhet të jemi të verbër ndaj shumë problemeve që ende ekzistojnë: ka mungesë të stabilitetit politik, i cili mund të jetë në mënyrë

⁷Pandolfi, ‘Myths and New Forms’, 208

të veçantë kërcënues ndaj një vendi me një traditë parlamentare të shkurtër dhe vulnerabël, ekonomia është e varfër, ka korrupsion dhe krim të organizuar, ka probleme të mjedisit. Këto mangësi nuk duhen nënvlerësuar, sepse ato mund të ngadalësojnë integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian dhe në strukturat Euro-Atlantike. Është e domosdoshme një përpjekje serioze e qeverisë shqiptare dhe e të gjithë qytetarëve shqiptarë në të gjitha këto fusha. Një problem i vecantë është i lidhur me çështjen e bashkëpunimit rajonal mbi të cilin po insiston kaq shumë Bashkimi Europian, nëpërmjet Paktit të Stabilitetit për Europën Juglindore.

Për Shqipërinë, mund të ketë qenë pothuaj një hap nga izolimi i plotë në bashkëpunimin në shkallë të gjerë me vendet fqinje – dhe me botën. Këtu është bërë, gjithashtu, një progres i madh. Duhet të kemi parasysh që arsyet e izolimit të pasluftës ishin të njëjtat që tani mund të rrezikojnë marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë. Është i mirënjohur tashmë fakti se ky izolim, në fakt, pak ka të bëjë me marrëveshjet ideologjike. Mosmarrëveshjet territoriale dhe pakënaqësitë në lidhje me trajtimin e komuniteteve shqiptare në vendet fqinje ishin shumë më të rëndësishme. Këto tensione fatkeqësisht ende nuk kanë përfunduar dhe pavarësisht nga deklaratat zyrtare rreth paprekshmërisë së kufijve dhe premtimit për t'iu shmangur ndërhyrjeve në punët e brendshme të njëri-tjetrit, mbetet ende shumë mosbesim midis Shqipërisë dhe fqinjëve të saj, siç është – me siguri - edhe midis të gjitha vendeve të tjera të Ballkanit. Ky mosbesim është pjesërisht për shkak të boshllëkut midis pikëpamjeve zyrtare, qeveritare në lidhje me çështjet territoriale, dhe opinioneve të cilat propagandohen krejt haptazi në librat shkollorë, novelat, telefilmata etj., dhe tentojnë të mbajnë gjithmonë opinionin publik në gjendjen e eksitimit të përherëshëm nacionalist. Si historian, unë nuk mund të ndihmoj duke ndjerë keqardhje për situatën skizofrenike në vendet e Ballkanit, ku ka, në njërën anë, një historiografi profesionale, që përkon me standartet ndërkombëtare shkencore, por studimet e të cilëve u rezervohen vetëm një grupi të vogël profesionistësh ndërkombëtarë, dhe, në anën tjetër, një historiografi popullore

ose populiste, e cila, në fakt, është një lloj mitologjie paranojake e njëanshme nacionaliste e përhapur prej mësues shkollash, gazetarë, shkrimtarë dhe – në interes të të huajve – nga guidat turistike. Për sa kohë është kjo mospërputhje dramatike midis deklaratave zyrtare të pakoordinuara dhe shpeshherë opinioneve publike nacionaliste agresive, të toleruara dhe madje në mënyrë të pakëshillueshme edhe të mbështetura nga politikanë dhe figura të tjera publike, nuk mund të flitet për besimit të plotë apo bashkëpunimit optimal. Problemi është se, – siç vuri në dukje një historian bullgar, – e vetmja historiografi korrekte është ajo që i përshtatet fqinjëve. Cfarë është e rëndësishme është aftësia për të pasur një pikëpamje kritike në lidhje me deklaratat, qëndrimet dhe veprimet e bashkëkombasve. Nuk është detyra e një intelektuali të mbrojë kombin e tij në kurriz të kombeve të tjera, por të mbrojë parimet universale që aplikohen në të gjitha kombet. Bashkëpunimi rajonal, integrimi dhe siguria, – dhe kjo lidhet, gjithashtu, me marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve etnike, bashkëjetesën brenda një shteti – nuk janë vetëm çështje të prezantimit të ligjeve të reja dhe strukturave, bashkimi me organizatat ndërkombëtare, të deklaratave zyrtare, por bazohet në besimin e vërtetë, mbështetur edhe nga vetë qytetarët.

Dëshiroj të përfundoj më një shënim mbi “vlerat Europiane” të cilave iu referova më lart. Vlerat janë demokracia, pluralizmi dhe tolerance fetare dhe etnike. Ato i përkasin thelbit të identitetit Europian. Sidoqoftë, në historinë Europiane demokracia, pluralizmi dhe tolerance fetare dhe etnike kanë qenë fenomene shumë të rralla. Tirania dhe diktatura, një mospëlqim i dukshëm i pluralizmit kulturor dhe fetar dhe intolerance etnike janë po aq tipike për historinë Europiane (perëndimore) sa edhe për historinë e Ballkanit, me përjashtim të – nga këndvështrimi historik – një periudhe shumë të shkurtër të Luftës së Dytë Botërore. Disa nga këto fenomene të dënueshme janë ende shumë të gjalla, falë suksesit të partive nacionaliste dhe raciste në shumë vende të Europës Perëndimore. Ata na shtyjnë të konsiderojmë Europianizimin jo si një trashëgimi kulturore, por si një projekt, dhe hyrjen në

Bashkimit European me më shumë autokritikë dhe më shumë mirëkuptim për mangësitë e të tjerave, që do të thotë, jo në terma si” mësues” dhe “nxënës”, por si partnerë, që bashkëpunojnë ngushtësisht për të realizuar projektin ambicioz European.

Mbi ankimin individual dhe përzgjedhjen e ankesave në Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë dhe më gjerë

(Një vështrim krahasues)

Denar Biba¹
MA

I. INDIVIDIVI SI ANKUES NË GJYKATËN KUSHTETUESE

Procedurat përpara Gjykatës Kushtetuese kanë natyrën e procedurave të nxitura (lat.-*juridiccion voluntaries*), pasi në parim (por edhe përgjithësisht në praktikë) Gjykata Kushtetuese nuk mund të bëhet iniciatore e fillimit të procedurave (*ex officio*)². Si rregull, investimi i Gjykatës Kushtetuese është i bazuar (faktikisht i kufizuar) nga kërkesat (ankimet) e sjella pranë saj vetëm nga një numër i mirëpërcaktuar subjektesh³ (të ashtuquajturit *subjekte të legjitimuara*).

Njëri prej subjekteve të lartpërmendura është edhe *individ* (kur çështja për të cilën është bërë ankim lidhet drejtpërdrejt me interesat e tij).

Një pjesë e sistemeve të kontrollit kushtetues e lejojnë aksesin e individëve privatë në Gjykatën Kushtetuese (kjo si në lidhje me kontrollin abstrakt,

¹ Autori është Drejtor i Marrëdhënieve me Publikun në Gjykatën Kushtetuese.

² Në bazë të Ligjit për Dispozitat Kryesore Kushtetuese, Gjykatës Kushtetuese të RSH-së i njihet drejta të niste procedura *ex officio*, prerogativ i cili u hoq me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së re në 1998, me motivacionin e shmangies së abuzimeve të mundshme.

³ Shih nenin 134 të Kushtetutës së RSH-së.

ashtu edhe atë konkret, bazuar tek rekursi individual, i cili në vendet e *common law* quhet *constitutional complaint*, ndërsa në Amerikën Latine – *amparo ose action popularis*). Kjo përfshin edhe të ashtuquajturin “kontroll kushtetues subjektiv” – pra, dhunimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e të drejtave të individit nga ndërhyrjet shtetërore.⁴

Në vendet e së drejtës romane ekzistojnë tri lloje rekursesh individuale:

i) *Rekursi kundër një ligji*: si një mjet që angazhon një procedurë subjektive dhe konkrete, sa herë që individi pretendon se i është kërcenuar ose cënuar një e drejtë e mbrojtur me kushtetutë.

ii) *Rekursi kundër një akti administrativ*: mund të drejtohet si rregull vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet e tjera juridike të zakonshme të mbrojtjes.

iii) *Rekursi kundër një vendimi gjyqësor*: është procedurë e përhapur në Europën Perendimore e Lindore. Në këto raste Gjykata Kushtetuese ngjan si një shkallë e katërt e juridiksionit të zakonshëm.⁵

Karakteristika e përbashkët e të gjitha vendeve që njohin rekursin individual kundër një ligji, akti administrativ ose vendimi gjyqësor është se vendimi kushtetues ka kryesisht efekte vetëm ndërmjet palëve (*inter partes*), përveçse në rastin kur objekti i çështjes për të cilën është dhënë vendimi është një akt legjislativ (këtu efekti është *erga omnes*).

Gjatë procesit vendimmarrës në vijim të rekurseve individuale, ku individët ankohen për shkelje të së drejtës së tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, Gjykata Kushtetuese shpesh vendoset në pozicionin e “gjykatës më të lartë dhe të fundit”, pasi Gjykata Kushtetuese, ndërsa shqyrton vendimet e gjykatave të zakonshme, faktikisht vepron si një shkallë e katërt (e katërta në radhë)⁶, situatë kjo që nuk ka kaluar pa probleme.

⁴ Garik Harutynyan & Arne Mavcic “Kontrolli Kushtetues dhe Zhvillimet e tij në Botën Moderne”, Yerevan-Lubljana, 1999.

⁵ Kristaq Traja, “Drejtësia Kushtetuese”, Luarasi, Tiranë, 2000.

⁶ Shih nenin 131 pika (f) të Kushtetutës së RSH-së.

Këtu nuk ka asgjë për t'u shqetësuar, pasi megjithëse Gjykata Kushtetuese nuk i përket juridiksionit të zakonshëm, edhe në këto raste (shumë të pakta) që mund të duken si devijime nga funksioni *original e historik* i saj, ajo sërish e gjen veten në zbatim të ligjit kushtetues⁷, i cili e vendos Gjykatën Kushtetuese në rolin e të vetmes gjykatë kombëtare kompetente për të gjykuar nëse një gjykatë e shkallës normale ka dhunuar ose jo të drejtat kushtetuese të qytetarit.

Statusi i individit përballë Gjykatave Kushtetuese është ndikuar nga interpretime të zgjeruara të dispozitave në lidhje me ankimin kushtetues, ashtu sikundër edhe nga interpretime akoma më të zgjeruara të dispozitave që kanë të bëjnë me kontrollin kushtetues konkret (rasti i Greqisë, Italisë, Zvicrës, SHBA etj.).⁸ Madje në disa sisteme, aksesit i individëve në Gjykatën Kushtetuese është bërë kaq “popullor”, sa që ai tashmë po kërcënon edhe kapacitetet funksionale të saj. Kjo është një situatë mjaft e njohur veçanërisht në Spanjë dhe Gjermani (ku rekursit individuale kanë njohur edhe suksesin e tyre më të madh). Mijëra ankesa filtrohen çdo vit nga një komision prej tri gjyqtarësh⁹, por shumica absolute e tyre nuk pranohen (afërsisht 97-98%)¹⁰.

Një situatë proporcionalisht e ngjashme ekziston edhe në Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë, ku vetëm gjatë vitit 2002 numri i çështjeve të sjella për gjykim ka qenë 243 në total, prej të cilave vetëm 18, ose 7.4 për qind, janë pranuar¹¹.

⁷ *Ibidem*.

⁸ Garik Harutyunyan & Arne Mavcic “Kontrolli kushtetues dhe zhvillimet e tij në botën moderne”, Yerevan-Lubljana, 1999.

⁹ Rregullat e Procedurës së Gjykatës Federale [Gjermane].

¹⁰ Nga fjala e z. Mathias Hartwig, përfaqësues i institutit gjerman “Max Planck”, mbajtur në seminarin “Përzgjedhja e kërkesave Individuale para Gjykatës Kushtetuese”, Tiranë, datë 4.7.2003.

¹¹ Statistika të Gjykatës Kushtetuese 2002, buletin për përdorim të brendshëm. Për të interesuarit, 1 kopje e tij gjendet në bibliotekën e këtij institucioni.

Nga masa e të gjithë kërkesave të paraqitura prej individëve vitin e kaluar (215 kërkesa ose 88 për qind e kërkesave në total), të cilët pretendonin mosrespektimin nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm të parimit kushtetues për një proces të rregullt ligjor, Gjykata Kushtetuese pranoi si të bazuara vetëm 11 kërkesa ose 5 për qind të totalit (një përqindje gjithmonë në ulje ndër vite, me gjithë numrin e kërkesave gjithnjë në rritje).

Këto shifra janë edhe një argument më shumë në mbështetje të faktit se Gjykata Kushtetuese nuk ka asnjë tendencë vetëpozicionimi në rolin e “një gjykate të shkallës së katërt”.

Ndërkohë, është më se normale që me një numër gjithnjë e në rritje të ankimeve pranë Gjykatave Kushtetuese, efektshmëria e vendimmarrjes së tyre tenton drejt uljes. Megjithatë, kjo nuk mund të shërbejë si pretekst për gjyqtarët e tyre, për të kufizuar mundësitë e qytetarëve që të ankohen në mbrojtje të të drejtave të tyre të shpallura me Kushtetutë, garante e së cilës është Gjykata Kushtetuese.

II. PËRZGJEDHJA E ANKESAVE NË GJYKATËN KUSHTETUESE

Seleksionimi paraprak i ankesave (ose e thënë ndryshe: ekzistenca e filtrave paraeliminatore) është padyshim një nga elementet bazë e që ndeshet në veprimtarinë e pothuajse të gjitha Gjykatave Kushtetuese.

Kjo procedurë ka njohur zhvillimin e saj më të madh veçanërisht në sistemin gjerman të drejtësisë kushtetuese, me synim eliminimin e ankesave potencialisht të pasuksesshme, duke krijuar në këtë mënyrë hapësira më të mëdha për Gjykatën Kushtetuese, që të refuzojë ankesa joserioze dhe të pathemelta.

Aktualisht, ky është një problem mjaft i mprehtë me të cilin po ndeshen sot gjykatat kushtetuese. Sfida nuk është edhe aq e lehtë: të duhet “të ndash miellin nga krundet” pa çenuar njëkohësisht sigurinë dhe efikasitetin e sistemit të mbrojtjes së të drejtave të individit për një proces të rregullt ligjor, si dhe parimet kryesore të demokracisë.

Në këtë kontekst ia vlen të përmendet se mbrojtja përmes ankimit kushtetues na çon drejtpërdrejt te bashkësia e të drejtave dhe lirive kushtetuese, bashkësi e mbrojtur me kushtetutë, por jo edhe aq e qartë përsa i përket veprimtarisë konkrete të gjykatave kushtetuese. Kështu p.sh., nëse Gjykatat Kushtetuese Sllovene apo Kroate tentojnë të mbrojnë *të gjitha* të drejtat kushtetuese, në sisteme të tjera, rrethi i të drejtave që mbrohen është shumë më i ngushtë. Ky është edhe rasti shqiptar, ku “për shkak të një zhvillimi të çuditshëm në procesin e miratimit të Kushtetutës në Parlament më 1998, “*procesi i rregullt ligjor*” i parashikuar në nenet 42/1 dhe 131/f të Kushtetutës mbeti *e vetmja* e drejtë themelore e individuale nga i gjithë katalogu i të drejtave të njeriut, që ruajti statusin e një të drejte të mbrojtshme në Gjykatën Kushtetuese”.¹²

Për t’u kthyer sërish te *përzgjedhja e ankesave*, do të vijoj me një ekspozë të shkurtër të përvojës së Gjykatës Kushtetuese Federale (Gjermane) dhe të disa gjykatave të tjera europiane.

Siç e thashë edhe më lart, duke qenë gjykatë e vetme e këtij lloji e një vendi disa dhjetra milionë banorësh, pranë Gjykatës Kushtetuese Federale regjistrohen çdo vit me mijëra ankesa, të cilat e kanë vështirësuar mjaft procesin vendimmarrës dhe kanë sjellë për pasojë vendosjen e detyrueshme të procedurave paraeliminatore.

Nuk ka rregulla të përcaktuara qartë për këtë; fillimisht kërkesa shqyrtohet nga një raportues (gjyqtar) i caktuar nga Kryetari (ose Presidenti) i Gjykatës, i cili brenda një periudhe kohe të arsyeshme ua bën të pranishëm vendimin e tij për refuzim ose jo anëtarëve të tjerë të kolegjit (panelit). Në bazë të nenit 93/a të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese Federale, një ankim kushtetues do të pranohet a) *vetëm nëse ai ka një rëndësi kushtetuese themelore* dhe b)

¹² Kristaq Traja, *Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe procesi i rregullt ligjor sipas Kushtetutës Shqiptare*, në Buletinin e Posaçëm të Gjykatës Kushtetuese dhe të Komisionit të Venecias “10 vjet Gjykatë Kushtetuese”, Tiranë, 2003.

nëse kjo bëhet me qëllim zbatimin e të drejtave themelore të njeriut, të cilat pretendohet se janë dhunuar nga një autoritet publik; pranimi mund të bëhet edhe në ratin kur c) ankuesi duket se do të pësojë një disavantazh të madh në rast se ankesa e tij do të refuzohet. Në të gjitha rastet e tjera ankesa refuzohet.¹³

Një procedurë fare e ngjashme ndiqet edhe në Gjykatën Kushtetuese Rumune ose atë Sllovene, ku sërisht gjyqtari raportues (i caktuar sipas planit të punës nga Kryetari i Gjykatës), pasi shqyrton paraprakisht ankesën dhe mbledh informacion ose merr shpjegimet e nevojshme, i paraqet kolegjit vendimin e tij nëse Gjykata Kushtetuese duhet të nisë procedurat e shqyrtimit ose jo. Njëlloj si në rastin gjerman, nisma për investimin e Gjykatës Kushtetuese nuk pranohet nëse ajo është haptazi e pathemeltë ose i referohet një çështjeje të parëndësishme (në konceptin kushtetues).¹⁴

Procedura paraeliminatore shumë më të detajuara gjenden në Ligjin Kushtetues Federal për Gjykatën Kushtetuese të Federatës Ruse. Në lidhje me këtë është përsëri Kryetari i Gjykatës, i cili, sipas procedurave të përcaktuara nga ligji i mësipërm, cakton një ose disa gjyqtarë, për të bërë përzgjedhjen paraprake (ose paraeliminatore) të kërkesave të regjistruara në Gjykatë. Kjo është një fazë e detyrueshme në këtë Gjykatë. Vendimi i gjyqtarit mbi rezultatet e kontrollit paraprak të kërkesës raportohet në sesionin plenar të Gjykatës Kushtetuese.¹⁵ Vendimi në lidhje me pranimin apo jo të kërkesës/ankesës merret nga Gjykata Kushtetuese në sesion plenar brenda një muaji nga përfundimi i kontrollit paraprak.¹⁶

¹³ Ligji mbi Gjykatën Kushtetuese Federale të Gjermanisë.

¹⁴ Kushtetuta dhe Ligji për Rregullat e Procedurës së Gjykatës Kushtetuese Sllovene dhe Rregullorja për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatës Kushtetuese Rumune.

¹⁵ Neni 41 i Ligjit Kushtetues Federal për Gjykatën Kushtetuese të Federatës Ruse.

¹⁶ Neni 42, *ibidem*.

Gjykata Kushtetuese e Federatës Ruse vendos mospranimin e kërkesës kur:

1. zgjidhja e çështjes së ngritur në kërkesë nuk është nën juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese;
2. ankimi nuk është në përputhje me kërkesat e Gjykatës Kushtetuese;
3. Gjykata Kushtetuese ka nxjerrë një vendim në lidhje me objektin e kërkesës, i cili është ende në fuqi.¹⁷

Për të sjellë përpara jush një praktikë absolutisht ndryshe, do t' i referohem Gjykatës Kushtetuese Italiane. Nga materialet e studiuara për përgatitjen e këtij punimi mësova se, kur bie fjala për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si një mbrojtje imediate dhe e drejtpërdrejtë, rendi ligjor italian nuk ia cakton këtë detyrë Gjykatës Kushtetuese, por gjyqtarit të zakonshëm, pavarësia e të cilit nga pushteti ekzekutiv e legjislativ garantohet prej Kushtetutës.¹⁸

Kushtetuta italiane nuk i njeh, individit të drejtën që, pasi ka shteruar të gjitha mjetet e tjera juridike, të vërë në lëvizje drejtpërdrejt Gjykatën Kushtetuese, sikundër ndodh në rendet ligjore që pranojnë kërkesat kushtetuese individuale. Me shterimin e tyre, shtetasi mund të paraqesë kërkesë vetëm përpara Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, mbështetur në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollin Shtesë nr. 11, i cili garanton rekursin e drejtpërdrejtë në këtë gjykatë nga një person i cili pretendon dhunimin e një të drejte të parashikuar nga Konventa.¹⁹

Ndryshe nga rasti italian, Kushtetuta e Shqipërisë në nenin 133, përcakton në mënyrë të përgjithshme (pa i ndaluar askujt) se “pranimi i ankesave për

¹⁷ Neni 43, *ibidem*.

¹⁸ Guido Neppi Modona, *Gjykata Kushtetuese dhe Mbrojtja e të Drejtave Themelore*, në Buletinin e Posaçëm të Gjykatës Kushtetuese dhe Komisionit të Venecias “10-vjet Gjykatë Kushtetuese”, Tiranë, 2003.

¹⁹ *Ibidem*.

grykim në Gjykatën Kushtetuese vendoset nga një numër gjyqtarësh”, duke ia lënë rregullimin e mëtejshëm të këtij çasti të rëndësishëm ligjit organik të këtij institucioni. Ky i fundit, në nenin e tij nr. 31, i cili bën fjalë për shqyrtimin paraprak të kërkesave, përcakton se “kërkesa shqyrtohet paraprakisht nga një kolegji i përbërë nga 3 gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, ku bën pjesë edhe relatori”²⁰. Kolegjet nga ana e tyre, pasi dëgjojnë relatorin e çështjes (edhe te ne i caktuar nga Kryetari i Gjykatës), i shqyrtojnë kërkesat nëse ato janë të plota ose jo (në këtë rast kolegji ia kthen kërkuuesve për plotësim, duke treguar shkaqet e kthimit dhe afatin e plotësimit)²¹, si dhe nga pikëpamja e legjitimitetit të subjekteve që i kanë sjellë dhe kompetencës së vetë Gjykatës në lidhje me objektin e ankimit.

Në mënyrë që çështja të pranohet dhe të kalojë në seancë plenare, kërkohet unanimiteti i të tri anëtarëve të kolegjit. Sikur edhe vetëm njëri prej tyre të mos jetë dakord, çështja kalon për shqyrtim (paraprak) në Mbledhjen e Gjyqtarëve.²²

Gjithsesi, në të gjitha rastet e mësipërme, kolegji ose Mbledhja e Gjyqtarëve nuk shqyrton zgjidhjen në themel të çështjes, çka është atribut vetëm i seancës plenare.

Përsa i përket shqyrtimit të ankesave individuale nga Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, këto ankesa vijnë vetëm për shkeljen e të drejtës kushtetuese të individit *për një proces të rregullt ligjor*, pasi të jenë shtuar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e tyre.

Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë ka krijuar jurisprudencën e vet, që në ndryshim nga Konventa Europiane, procesin e rregullt e merr kryesisht në

²⁰ Neni nr. 31 i ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

²¹ Paragrafi I, *ibidem*.

²² Kujtim Puto, *Përzgjedhja e kërkesave individuale nga kolegjet*, punim i lexuar në seminarin “Përzgjedhja e kërkesave individuale para Gjykatës Kushtetuese”, Tiranë, datë 4.7.2003.

kuptimin e ngushtë procedural, duke kuptuar me këtë kontrollin kushtetues mbi veprimtarinë kryesisht procedurale të gjykatave gjatë procesit të shqyrtimit të çështjeve e të marrjes së vendimeve, domethënë kontrollin për respektimin e parimeve bazë kushtetuese të procesit. Mungesa/mosfaktimi i pretendimeve për një proces të parregullt ligjor ose konfondimi i tij me vlerësimin e provave ose interpretimin e ligjit, janë edhe shkaqet kryesore që kanë çuar drejt moskalimit të çështjeve për gjykim dhe refuzimin e tyre nga ana e kolegjeve ose Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese²³.

KONVENTA EUROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE ANKIMI INDIVIDUAL

Ankimi individual në trajtimin e tij në këtë punim, është parë i lidhur me konceptin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut brenda juridiksionit kushtetues kombëtar. Megjithatë, një sërë dokumentesh ndërkombëtare parashikojnë, gjithashtu, mjete juridike në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut në formën e ankimeve (individuale ose jo).²⁴ Gjithsesi, në vijim, për arsye pragmatike, jam fokusuar vetëm te Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut e 4 nëntorit 1950 (këtu e në vijim Konventa).

Megjithatë, e gjej me vend të shtoj se, megjithëse shumica e njerëzve në rajonin tonë besojnë se të drejtat e tyre njerëzore të dhunuara nga mekanizmat shtetërorë janë më mirë të mbrojtura nga procedurat e ngritura në kuadrin European, është e rëndësishme të mbajmë ndër mend se, ndonëse sistemi i OKB-së për mbrojtjen e këtyre të drejtave është më pak efektiv, sërish ai është më i shpejtë. Ndaj, në ato çështje ku elementi *kohë* duket të jetë më i

²³ *Ibidem*.

²⁴ P.sh. Protokoll i Fakultativ i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike i OKB-së (19.12.1966) lejon viktimat e dhunimit të të drejtave të mësipërme të dërgojnë ankesat e tyre drejtpërdrejt në Komitetin për të Drejtat e Njeriut; Deklarata për të Drejtat dhe Liritë Themelore e Parlamentit European (12.04.1989); Konventa Amerikane mbi të Drejta e Njeriut (22.11.1969) etj.

rëndësishmi, sistemi i Kombeve të Bashkuara mund të jetë zgjidhja më e mirë.

Duke u rikthyer te Konventa Europiane, neni 35 i saj parashikon se “Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut – këtu e në vijim Gjykata, mund të pranojë ankimin e çdo *personi fizik*, të çdo organizate joqeveritare ose të çdo grupi individësh, të cilët e ndiejnë veten viktimë e shkeljes së të drejtave të njohura në Konventë dhe në Protokollet e saj nga një nga palët e larta kontraktuese. Palët e larta kontraktuese zotohen të mos pengojnë në asnjë mënyrë ushtrimin e efektshëm të kësaj të drejte.”

Ankues mund të jetë vetëm personi fizik ose juridik, i cili dëshmon se ka qenë drejtpërdrejt dhe personalisht i dëmtuar nga veprimi ose mosveprimi, që është objekti i akuzës. Në kuptimin e Konventës, ai është personi realisht i dëmtuar nga veprimi ose nga mosveprimi që përbën shkelje të Konventës (*actual victim*).

Tanimë është e qartë se mekanizmat mbrojtës të Strasburgut janë të karakterit komplementar në raport me sistemet e brendshëm të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.²⁵ Kështu, ndërsa parashikon *kushtet e pranueshmërisë* së një ankimi në Gjykatë, Konventa shprehet qartë se “Gjykata nuk mund të vihet në lëvizje, përveçse kur janë shterur mjetet e brendshme ligjore, ashtu siç kuptohen sipas parimeve të së drejtës ndërkombëtare përgjithësisht të pranuar dhe brenda një afati prej gjashtë muajsh nga data e vendimit të brendshëm përfundimtar”.²⁶ Kushti i afatit kohor të përcaktuar është përfshirë për të shmangur diskutimin e vendimit pas një periudhe të gjatë dhe për të garantuar sigurinë ligjore.²⁷ Megjithatë, në situata të veçanta, kur

²⁵ Vendimi “*Handyside kundër Britanisë së Madhe*”, i datës 7.12.1976, A.24, par. 48; “*Akdivar dhe të tjerë kundër Turqisë*”, i datës 16.09.1996, RJD 1996-IV, par. 65.

²⁶ Neni 35, pika 1 e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

²⁷ Vendimi “*X kundër Francës*” i datës 13.12.1982, ankimi nr. 9587/81 DR 29/228.

paraqiten prova që tregojnë rrethana të jashtëzakonshme, në pajtim me parimet e njohura gjerësisht të së drejtës ndërkombëtare, ankesat mund të pranohen edhe përtej afatit gjashtë mujor.²⁸

Gjykata në zbatim të Konventës²⁹ dhe praktikës së vendosur nga ajo vetë, mund të refuzojë një ankim si të papranueshëm edhe për shkaqe të tjera.

Së pari, ankimi nuk mund të jetë anonim. Gjithashtu, ankuesi nuk mund të abuzojë me të drejtën e ankimit. Vetëm për këtë arsye janë refuzuar shumë ankesa.³⁰

Gjithashtu, në bazë të nenit 3, paragrafi 2, pika (b) e Konventës kërkesa individuale nuk do të pranohet kur ajo është në thelb e njëjtë me një kërkesë të shqyrtuar më parë nga Gjykata ose që i është shtruar për zgjidhje një instance tjetër ndërkombëtare hetimore ose vendimore dhe kur ajo nuk përmban fakte të reja. Këto krijojnë punë të tepërt dhe e pengojnë Gjykatën në përmbushjen e detyrave që burojnë nga Konventa.³¹

Ankesat, gjithashtu, refuzohen nëse duket qartë se janë të paarsyeshme, pra, që gjatë shqyrtimit fillestar duket që janë pa baza. Kjo mund të ndodhë për shkaqe të ndryshme: të interpretimit të gabuar të Konventës nga ankuesi, të ngritjes së pretendimeve krejtësisht të pabazuara ndaj autoriteteve ose të mungesës së provave të mjaftueshme në mbështetje të fakteve të paraqitura.³²

²⁸ Vendimi “*K kundër Irlandës*” i datës 17.05.1997, ankimi nr. 10416/83, DR 38/158.

²⁹ Neni 35, pikat 2 e 3 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

³⁰ Marek Antoni Nowicki, *Rreth Konventës Europiane-komentar i shkurtër mbi Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut*, Botim i Qendrës Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, Morava, Tiranë, 2003.

³¹ Vendimi “*Nieminen kundër Finlandës*” i datës 6.4.2000, Dhoma (Seksioni) IV, ankimi nr. 54510/2000

³² Marek Antoni Nowicki, *Rreth Konventës Europiane-komentar i shkurtër mbi Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut*, Botim i Qendrës Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, Morava, Tiranë, 2003.

Vend të veçantë zënë ankesat që dëshmojnë për kërkimin në Strasburg të një instance tjetër gjyqësore. Ankuesit apelojnë vendimet e gjykatave kombëtare, që atyre u duken të padrejta. Ankesa të tilla hidhen poshtë, pasi Gjykata e Strasburgut nuk është edhe një gjykatë tjetër e hierarkisë gjyqësore, e cila duhet të kontrollojë nëse vendimi ka qenë i drejtë, pra, nuk është e ashtuquajtura instanca e katërt gjyqësore. Kjo u përket gjykatave të vendit. Detyra e Gjykatës, në të tilla raste, kufizohet vetëm në çmimin, nëse vendimi është dhënë në rrugën e një procesi të rregullt gjyqësor, me respektimin e të gjitha garancive të përmendura në nenin 6 të Konventës. Ky kusht duhet mbajtur mend nga ankuesit.³³

Përsa i përket procedurave të Gjykatës së Strasburgut, ato janë relativisht të ngjashme me ato të gjykimit në një Gjykatë Kushtetuese. Ankesa paraqitet drejtpërdrejt në Gjykatë në adresën e sekretarisë. Ajo duhet të jetë konform kërkesave të parashikuara. Ankesa i drejtohet njëjës nga Dhomat (Seksionet), kryetari i së cilës, pas regjistrimit të saj, cakton, ndërmjet gjyqtarëve që e përbëjnë atë, referuesin përgjegjës për ndjekjen e çështjes. Çështjet më të thjeshta shqyrtohen prej komiteteve me 3 anëtarë, të cilat mund ta hedhin poshtë ankesën, duke e cilësuar atë të palejueshme ose ta heqin nga lista. Këtu, kusht është unanimiteti i të gjithë anëtarëve. Në mungesë të unanimitetit çështja kalon për shqyrtim në Dhomë, e cila është e përbërë nga 7 anëtarë. Seancat përgjithësisht janë publike, përveçse kur për rrethana të jashtëzakonshme vendoset ndryshe.

Sikundër kuptohet edhe nga ana procedurale, ankimi individual në Gjykatën e Strasburgut është një mjet juridik ndërkombëtar mjaft i krahasueshëm me ankimin (kombëtar) pranë një Gjykate Kushtetuese. Në të dy rastet, ankimi individual shërben si një garanci në mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe është një mjet juridik ndihmës i kushtëzuar nga shterimi i mjeteve të tjera në

³³ *Ibidem.*

kuadër të juridiksionit të zakonshëm gjyqësor. Dallimi kryesor mes tyre qëndron në fuqinë e vendimit që i pason, pasi ndryshe nga vendimi i një Gjykate Kushtetuese, *i cili përgjithësisht ka fuqi detyruese të përgjithshme dhe është përfundimtar*, në rastin e Gjykatës së Strasburgut, vendimi është thjesht i karakterit *deklarativ mbështetës*.³⁴ Megjithatë, asnjë shtet (palë e lartë kontraktuese) deri më sot, ndonëse mund ta ketë vonuar, por kurrë nuk ka guxuar të mos zbatojë një vendim të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Konseguencat do të ishin të jashtëzakonshme.

Por ne, ndërsa kemi edhe disa muaj kohë për t'u përballur me ndonjë vendim të Strasburgut³⁵, le ta fillojmë me respektimin e vendimeve të Gjykatës tonë Kushtetuese.

³⁴ Garik Harutyunyan & Arne Mavcic “Kontrolli kushtetues dhe zhvillimet e tij në botën moderne”, Yerevan-Lubljana, 1999.

³⁵ Prej disa vitesh janë mbi 60 çështje me kërkuar shqiptarë në pritje për t'u marrë në shqyrtim nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut. Ndoshta nga fundi i këtij viti (2003) ose fillimi i vitit tjetër mund të na sjellë surprizat (gjobat) e para.

Nga punimet e Kuvendit për periudhën prill-korrik 2003

*Përgatiti
Alma Kondakçi*

I. Raporte të komisioneve të përkohshme dhe të institucioneve të pavarura

1. Raport i Komisionit Hetimor Parlamentar “Për shqyrtimin e ligjshmërisë së përdorimit të fondeve publike dhe të ardhurave të tjera në Ministrinë e Kulturës, Rinisë e Sporteve dhe Bashkinë e Tiranës për periudhën 1992-2002, si dhe zbatimin e ligjshmërisë për zhvillimin urbanistik në Tiranë për periudhën 1992-2002” (mbajtur në seancë plenare më 12-17.6.2003)

Ky Komision, me objekt si më sipër, u paraqit në seancë plenare me dy raporte:

Në Raportin e paraqitur nga deputetët socialistë, anëtarë të këtij Komisioni, jepet përgjigje për akuzat e ngritura nga deputetët e Partisë Demokratike, duke argumentuar se ato janë të pabazuara. Sipas Raportit, puna në Ministrinë e Kulturës, Rinisë e Sporteve gjatë viteve 1998-2000 ka përmirësime të ndjeshme në krahasim me vitet 1992-1997; është rritur numri i projekteve, vlera e fondeve për investime në buxhet ka rritje të konsiderueshme. I njëjti përfundim arrihet edhe për punën e bërë në Bashkinë e Tiranës, ku gjatë periudhës 2000-2002 vihen re përmirësime të ndjeshme në fushën e përdorimit të fondeve publike dhe të planifikimit urban në krahasim me periudhën 1992-2000. Në Raport arrihet në përfundimin se Komisioni Hetimor nuk ia arriti qëllimit të paracaktuar nga Kushtetuta, ligji dhe vendimi i Kuvendit. Komisioni

nuk respektoi objektin e veprimtarisë së tij, ka vepruar në shkelje të parimeve bazë të konventave ndërkombëtare, Kushtetutës, ligjit dhe Rregullores së tij të brendshme, nuk respektoi objektin e hetimit, planin hetimor, duke shkelur procedurat ligjore; nuk arriti në përfundime të plota e konsensuale në mbyllje të procesit hetimor. Në përfundim, raporti pasqyron disa rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe të marrëdhënieve ndërinstitucionale.

Në Raportin i paraqitur nga deputetët e opozitës, anëtarë të Komisionit, pasqyrohen rezultatet e kontrollit të ushtruar në Ministrinë e Kulturës, Rinisë e Sporteve dhe në Bashkinë e Tiranës për periudhën 1992-2002, ku u vërejtën një numër i konsiderueshëm shkeljesh ligjore dhe abuzimesh në financimet e projekteve kulturore, në ligjin “Për prokurimin publik”, ligjet fiskale etj. Çdo shkelje ligjore vërtetohet nëpërmjet të dhënash, faktesh e argumentesh konkrete. Në përfundim, në Raport propozohet që përfundimet e tij t’i dërgohen Prokurorisë për të thelluar hetimet.

Edhe gjatë diskutimit në Komisionin Hetimor Parlamentar dhe në seancë plenare u mbajtën dy qëndrime të kundërta: Përfaqësuesit e Qeverisë dhe deputetët e mazhorancës mbështetën Raportin e paraqitur nga deputetët socialistë. Ata theksuan se veprimtaria e Komisionit Hetimor të Kuvendit ishte antikushtetuese, antiligjore dhe e dështuar dhe, nëpërmjet akuzave të pabazuara, të cilat konsiderohen si shkelje e parimit të prezumimit të pafajësisë, kishte qëllimin politik të godiste figurën e Edi Ramës. Ata vlerësuan punën e bërë nga Qeveria dhe Kryetari i Bashkisë së Tiranës për punën dhe ndryshimet e mëdha në kryeqytet.

Deputetët e opozitës vlerësuan Raportin e paraqitur nga përfaqësuesit e tyre në Komisionin Hetimor dhe kërkuan me ngulm që të gjitha shkeljet ligjore e abuzimet, të pasqyruara në Raport, të shqyrtohen nga organi i Prokurorisë. Ata theksuan se ndryshimet në Tiranë kanë ndodhur si rezultat i një politike të gabuar të Qeverisë, e cila e ka përqendruar dhënien e mjeteve financiare në qytetin e Tiranës, duke lënë pas dore zonat periferike, për të krijuar një imazh të rremë.

Në përfundim, me shumicë votash, Kuvendi miratoi raportin e paraqitur nga deputetët socialistë.

2. Raport i Komisionit Hetimor Parlamentar për hetimin e veprimtarisë së Qeverisë për transparencën e procesit të firmave piramidale (mbajtur në seancë plenare më 14-15 korrik 2003)

Edhe ky Komision Hetimor Parlamentar u paraqit në Kuvend me dy raporte:

Në Raportin e paraqitur nga deputetët socialistë pasqyrohen shkaqet e lulëzimit të tregut joformal të kreditimit nëpërmjet krijimit të firmave piramidale, si mungesa e besimit për depozitimin e kursimeve të popullsisë të tri bankat shtetërore që ekzistonin në vitet 1995-1996, ngadalësia e krijimit të bankave private në atë kohë, të cilat nuk ishin të interesuara për të tërhequr depozitën në valutën vendase, pamjaftueshmëria e sistemit të pagesave, dobësitë në mbikëqyrjen bankare, të cilat krijuan mendësinë që huatë e marra nga bankat shtetërore të mos shiheshin si të detyrueshme për t'u paguar, duke rritur kreditë e këqija etj. Sipas Raportit, pamjaftueshmëria e kuadrit ligjor për të luftuar skemat piramidale u shfrytëzua nga Qeveria për të fituar zgjedhjet e vitit 1996. Qeveria konsiderohet si një vëzhguese pasive e kësaj dukurie, duke mos marrë asnjë masë për bllokimin e rrjedhjes financiare nga bankat për shoqëritë huamarrëse. Gjithashtu, në Raport pasqyrohet puna dhe rezultatet e shoqërisë Deloitte & Touche dhe e administratorëve të pavarur, të cilët morën në administrim shoqëritë huamarrëse. Përfundimi i punës së administratorëve të pavarur ishte se shoqëritë huamarrëse nuk kishin mjete financiare për shlyerjen e borxhit ndaj kreditorëve dhe asetet që ato zotëronin ishin, në përgjithësi, veprimtari me humbje. Sipas raportit, procedurat, kriteret dhe rregullat e shitjes së asetëve të shoqërive huamarrëse janë zbatuar drejt, mbështetur në ligj dhe vlerat financiare të arkëtuara në mbi 50 për qind të tyre janë më të larta se çmimi fillestar i hapjes së ankandit.

Në Raportin e paraqitur nga deputetët e opozitës, anëtarë të Komisionit, pas argumenteve e fakteve të shumta, arrihet në përfundimin se ndërhyrja e

Këshillit të Ministrave dhe e strukturave të caktuara prej tij në shoqëritë huamarrëse është kryer në kundërshtim me parimet kushtetuese dhe aktet ligjore. Shitja e aseteve, sipas Raportit, është bërë në mënyrë të paligjshme dhe abuzive. Në Raport jepen fakte të shumta për vlerësimin dhe shitjen e pasurisë së shoqërive huamarrëse me çmime joreale, shumë më të ulëta se vlera e tyre, duke dëmtuar rëndë interesat e kreditorëve. Në përfundim, deputetët e opozitës propozojnë që ky Raport t'i dërgohet Prokurorisë për hetim të mëtejshëm.

Gjatë debatit në Komision dhe në seancë plenare deputetët mbajtën dy qëndrime të kundërta për veprimtarinë e transparencës së procesit të firmave piramidale:

Deputetët socialistë, pasi akuzuan Qeverinë Demokratike për lejjimin e krijimit të firmave piramidale, për mbështetjen dhe keqpërdorimin politik të tyre, duke i shkaktuar vendit një krizë të rëndë buxhetore dhe duke goditur rëndë sistemin bankar, vlerësuan punën dhe kontributin e Qeverisë dhe të strukturave të saj për çrrënjosjen dhe shpërbërjen e skemave piramidale. Lidhur me akuzën e deputetëve opozitarë se shitja e aseteve të skemave piramidale është bërë nën vlerën e tyre reale, ata u shprehën se kjo shitje është bërë me ankand ose tender publik dhe është bazuar në vlerën ose çmimin e tyre në treg, në funksion të kërkesës dhe ofertës. Ata u shprehën se synimi kryesor i shtetit në ndihmë të kreditorëve mbetet shitja sa më e shpejtë e aseteve të mbetura. Përfaqësuesit e Qeverisë konfirmuan qëndrimin e saj lidhur me fondet financiare të mbetura dhe të pashpërndara të fondacioneve bamirëse, të cilat janë ngurtësuar pranë Bankës së Kursimeve në dobi të kreditorëve që kanë humbur banesat nga rënia e skemave piramidale, për shkak të vlerave tepër të ulëta që ato paraqesin dhe të pamundësisë së shpërndarjes së tyre.

Deputetët e opozitës mbështetën Raportin e paraqitur nga përfaqësuesit e tyre në Komisionin Hetimor, duke kërkuar dërgimin e tij për hetim në Prokurori.

Në përfundim, Kuvendi miratoi me shumicë votash Raportin e paraqitur nga deputetët socialistë, anëtarë të Komisionit Hetimor Parlamentar.

3. Raport i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2002 (mbajtur në seancë plenare më 29.4.2003)

Në raportin e tij Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Shkëlqim Cani, informoi Kuvendin për treguesit kryesorë të zhvillimit të ekonomisë shqiptare gjatë vitit 2002.

Rezultatet financiare të veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë vlerësohen në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Të ardhurat valutore janë realizuar më shumë se plani, kryesisht si efekt i rritjes së rezervave valutore.

Gjatë debatit të zhvilluar në seancë plenare për raportin e Guvernatorit, deputetët e mazhorancës e mbështetën atë. Deputetët e opozitës shprehën disa kundërshtime lidhur me Raportin dhe kritikuan punën e Qeverisë dhe të Guvernatorit në disa drejtime, si për nivelin e ulët të vjeljes së të ardhurave fiskale, për ecurinë e ngadaltë të procesit të privatizimit, për nivelin e ulët të investimeve dhe rritjen e shpenzimeve korrente, uljen e numrit të të punësuarve, çka ka sjellë rënie të prodhimit të brendshëm bruto, rritjen e inflacionit, bllokimin e kredive për biznesin, pakësimin e totalit të kredisë së brendshme, ritmet e rritjes së veprimtarisë bankare më pak se ato të rritjes së ekonomisë etj.

Në përfundim, Kuvendi miratoi me shumicë votash Raportin e paraqitur nga Guvernatori.

II. Projektligje të shqyrtuara në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare

1. Projektligj “Për miratimin e kriterëve dhe të termave kryesore të zgjidhjes së borxhit të jashtëm të trashëguar të papaguar të Shqipërisë” (miratuar në seancë plenare më 29.5.2003)

Projektligji përcakton disa kriterë dhe terma kuadër, në të cilat duhet të

mbështetet veprimtaria e Qeverisë dhe e stafeve teknike të saj gjatë negociimit dhe zgjidhjes së borxhit të jashtëm të Republikës së Shqipërisë. Gjatë debatit në Komisionin e Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit dhe në seancë plenare deputetët e mbështetën plotësisht projektligjin.

Nga disa deputetë të opozitës u sugjerua që të bëhet kujdes për marrjen e borxheve të reja, pasi ritmet e kreditimit janë të mëdha dhe shpesh normat e interesit për kreditë që merren janë të larta. Prandaj, ata kërkuan që të përcaktohen kritere ligjore edhe për borxhet e reja dhe shlyerjen e tyre. Gjithashtu, deputetët rekomanduan që strategjia e shlyerjes së borxheve të bashkërendohet me programin për uljen e varfërisë. Në këtë kuadër, ata sugjeruan që të bëhet një strategji për detyrimet e Qeverisë për borxhin në tërësi, si atij të jashtëm, ashtu edhe të borxhit të brendshëm.

2. Projektligj “Për borxhin shtetëror dhe garancitë e huave shtetërore të Republikës së Shqipërisë”

Projektligji i mësipërm po shqyrtohet në komisionet e Kuvendit, të cilat ende nuk e kanë përfunduar diskutimin e tij. Ai synon të përcaktojë procedurat, detyrat dhe përgjegjësitë për sigurimin e huamarrjes së brendshme dhe të jashtme, si dhe garancitë e huave shtetërore të Republikës së Shqipërisë. Çështja më e debatueshme në Komisionin e Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit është zgjidhja e kontradiktës që krijohet midis këtij projektligji dhe ligjit nr.8379 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë”, lidhur me autoritetin që ka të drejtë të marrë hua nga institucionet ndërkombëtare dhe shtete të ndryshme. Sipas ligjit organik të Buxhetit, të drejtën për të marrë hua e ka Këshilli i Ministrave, ndërsa sipas këtij projektligji kjo kompetencë i jepet Ministrit të Financave. Në projektligji nuk parashikohet shfuqizimi i dispozitave që kanë të bëjnë me këtë çështje në ligjin organik të Buxhetit. Diskutimi për këtë çështje dhe për projektligjin në tërësi do të vazhdojë.

3. Projektligj “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare dhe konfliktit të interesave të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (miratuar në seancë plenare më 10.4.2003)

Duke pasur parasysh mangësitë në zbatimin e ligjit ekzistues, për këtë projektligj ka patur debate të gjera nga deputetët në mbledhjet e komisioneve të përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare. Veçanërisht, në Komisionin e Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit çështja më e debatueshme ka qenë gjetja e një zgjidhjeje optimale për krijimin e një institucioni të besueshëm dhe sa më të pavarur për kontrollin e pasurisë dhe të detyrimeve financiare të të zgjedhurve e disa nëpunësve publikë. Deputetët, mbështetur në përvojën e vendeve të tjera, dhanë alternativa të ndryshme për institucionin që do të kontrollojë deklarimin e pasurisë së personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë. Kuvendi miratoi edhe një sërë ndryshimesh në formulimin e disa neneve të projektligjit.

4. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik” (miratuar në seancë plenare më 8.5.2003)

Ndryshimet e këtij projektligji synojnë përmirësimin e ligjit ekzistues, mbështetur në korigjimin e disa mangësive që janë vërejtur në praktikën e zbatimit të tij.

Gjatë diskutimit të këtij projektligji në komisionet e përhershme të Kuvendit deputetët morën edhe mendimin e drejtuesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të cilët kanë informuar Kuvendin për disa shkelje ligjore në zbatimin e këtij ligji dhe kanë dhënë rekomandimet përkatëse për përmirësimin e tij. Ndryshimet kryesore të këtij ligji, të cilat u miratuan nga deputetët, kanë të bëjnë me zbatimin e rregullave të ligjit “Statusi i nëpunësit civil” për nivelin drejtues dhe ekzekutues të punonjësve të Agjencisë së Prokurimit Publik, përmirësimin e metodave për vlerësimin e ofertës më të mirë, nëpërmjet përdorimit të metodës së vlerësimit monetar, përmirësimin ligjor në fushën e ruajtjes dhe të manipulimit të dokumenteve të prokurimit, rregullimin ligjor të mundësisë së zëvendësimit të ofertave etj.

Deputetët, me shumicë votash, kundërshtuan dhe nuk miratuan propozimin e Këshillit të Ministrave për heqjen nga prokurimi të shërbimeve këshillimore. Gjithashtu, ata nuk miratuan propozimin e paraqitur në projektligj për dhënie

e së drejtës subjekteve konkurruese për të kryer ndërtime publike me fondet e veta, të kthyeshme nga Buxheti i Shtetit, duke u shprehur që kjo çështje duhet të gjejë më parë zgjidhje në ligjin “Për Buxhetin e Shtetit”.

5. Projektligj “Për sektorin e energjisë elektrike” (miratuar në seancë plenare më 22.5.2003)

Ky projektligj ka për qëllim të zgjerojë e forcojë veprimtarinë e Entit Rregullator të Energjisë Elektrike, të sigurojë liberalizimin e sektorit të energjisë elektrike në të tërë komponentët e tij, për t’u krijuar garancitë institucionale sipërmarrësve që të investojnë në këtë sektor dhe për të siguruar mbrojtjen e konsumatorëve.

Gjatë shqyrtimit të këtij projektligji në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare, deputetët diskutuan dhe miratuan disa ndryshime në formulimin e tij. Ndryshime u bënë në nenin që bën fjalë për mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve të bordit drejtues të ERE-së, duke e kaluar kompetencën për emërimin e tyre nga Këshilli i Ministrave, sipas projektligjit të paraqitur, te Kuvendi, me propozim të një ekipi përzgjedhës, i cili përbëhet nga përfaqësues të Kuvendit dhe ministri përgjegjës për energjinë. Gjithashtu, u ndryshuan kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve të bordit. Ndryshime u bënë në nenin që bën fjalë për mënyrën e marrjes së vendimeve nga bordi, apelimin e tyre, në nenin që bën fjalë për kompetencat e ERE-së në fushën e dhënies së licencave, refuzimit të kërkesës së ndonjë aplikanti për licencë etj.

6. Projektligj “Për mbrojtjen e konkurrencës” (miratuar në seancë plenare më 28 korrik 2003)

Ndryshimi thelbësor i këtij projektligji në krahasim me ligjin ekzsitues është mënyra e trajtimit të llojeve të marrëveshjeve, përqendrimeve dhe abuzimit me pozicionin dominues. Gjithashtu, në projektligj parashikohet ngritja e statusit të Drejtorisë së Konkurrencës Ekonomike në një institucion të veçantë publik, të pavarur, i quajtur “Autoritet i Konkurrencës”. Ky Autoritet ka si organ vendimmarrës Komisionin e Konkurrencës, i cili është parashikuar të zgjidhet nga Kuvendi.

Gjatë diskutimit për projektligjin në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare u propozuan mjaft riformulime e ndryshime në disa nene të tij, me qëllim qartësimin ose ndryshimin e përmbajtjes së tyre. Konkretisht, u bënë disa ndryshime në nenin që përcakton mënyrën e zgjedhjes dhe të zëvendësimit të anëtarëve të Komisionit të Konkurrencës, duke ndryshuar institucionet që kanë të drejtën e propozimit të kandidaturave të anëtarëve të Komisionit. Gjithashtu, u saktësua neni që bën fjalë për fillimin e hetimit nga Autoriteti i Konkurrencës, si dhe shumë ndryshime të tjera.

7. Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8610, datë 17.5.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave” (miratuar në seancë plenare më 19.6.2003)

Ndryshimi i disa neneve të ligjit ekzistues dhe plotësimi i tij me disa dispozita të tjera është bërë i nevojshëm për shkak të detyrimeve që kanë lindur nga ratifikimi me ligj i konventave ndërkombëtare kundër pastrimit të parave, si dhe për të korrigjuar disa mangësi nga zbatimi në praktikë i këtij ligji. Në projektligj propozohet që Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave të ushtrojë funksionet e “Autoritetit Përgjegjës”, si njësi e specializuar financiare për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftën kundër kësaj dukurie, si dhe luftën kundër financimit të terrorizmit. Krahas këtij institucioni, propozohet të krijohet Komiteti Kombëtar i Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave, i cili mblidhet dy herë në vit dhe ka për detyrë kryesore të përcaktojë drejtimet e politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e parandalimit dhe luftës kundër pastrimit të parave. Gjatë diskutimit të projektligjit disa deputetë u shprehën kundër krijimit të këtij Komiteti, pasi, sipas tyre, ai mund të jetë një hallkë e tepërt për zbatimin e ligjit. Pas votimit, deputetët nuk e ndryshuan propozimin e paraqitur nga Këshilli i Ministrave për këtë çështje.

Lidhur me detyrimin që u vihet punonjësve të bankave për të njoftuar Autoritetin Përgjegjës për transaksionet e dyshimta për pastrim parash të klientëve të tyre, në Komisionin e Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit

pati mjaft diskutime nga deputetët. Për këtë çështje, ky Komision thirri në një mbledhje të tij Drejtorin e Unionit të Bankave, Adrian Fullani, i cili ngriti shqetësimin se një detyrim i tillë cënon nenin që bën fjalë për ruajtjen e sekretit bankar të ligjit mbi të cilin funksionojnë bankat. Një detyrim i tillë, sipas tij, duhet të shoqërohet me masa tekniko-administrative, për të mos çuar në sterilizimin e futjes së parave të popullatës në banka dhe në rritjen e ekonomisë informale. Në përfundim të diskutimit dhe pas votimit, deputetët miratuan propozimin e Këshillit të Ministrave për këtë çështje.

Në Komisionet e Kuvendit dhe në seancë plenare u bënë edhe një sërë ndryshimesh të tjera të projektligjit.

8. Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8609, datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8780, datë 30.5.2001 (miratuar në seancë plenare më 19.6.2003)

Ky projektligj u hartua nga Komisioni Parlamentar Dypalësh, me përfaqësues të të gjitha focave politike parlamentare, i cili bëri amendimet e nevojshme në Kodin Zgjedhor, mbështetur në rekomandimet e OSBE/ODHIR-it, hartuar në vijim të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2001. Amendamentet e miratuara nga ky Komision konsistojnë në këto çështje: paketa e ankimeve dhe apeli me brenda administratës zgjedhore në nivelin e Gjykatës së Apelit; roli i medias në fushatën zgjedhore; raportet e ekzekutivit në nivel qendror e vendor përballë zgjedhjeve; roli i policisë në fushatat zgjedhore; regjistrimi i kandidatëve dhe subjekteve zgjedhore; procedurat e hartimit të listave të votuesve; dokumentacioni i zgjedhjeve; zgjerimi i të drejtave të votimit në procesin zgjedhor; dispozitat për shpërndarjen dhe datën e zgjedhjeve.

Përveç amendamenteve të mësipërme, hartimi i Kodit Zgjedhor u bazua edhe në dy Protokoll Marrëveshje, të lidhura midis përfaqësuesve të dy forcave politike më të mëdha në vend, nën asistencën dhe ekspertizën e OSBE/ODHIR-it.

Gjatë shqyrtimit të këtij projektligji në seancë plenare disa deputetë që

përfaqësojnë grupet e vogla parlamentare, anëtarë të komisionit bipartizan, paraqitën kundërshtime lidhur me disa amendamente të Kodit Zgjedhor. Konkretisht, ata kundërshtuan nenin që bën fjalë për zëvendësimin e deputetit në rast se mandati i tij mbaron në mënyrë të parakohshme, mosparashikimin në Kod të mbarimit të mandatit të anëtarit të KQZ-së kur ka rotacion politik, vënien e partive politike para detyrimit për të paraqitur kandidatë në 100 zona zgjedhore, mosparashikimin në Kod të procedurave të plota për votimin e anëtarëve të KQZ-së etj. Vërejtjet dhe propozimet e tyre u shqyrtuan në seancë plenare dhe nuk u miratuan nga shumica e deputetëve. Për këtë arsye, deputetët anëtarë të komisionit bipartizan, përfaqësues të grupeve të vogla parlamentare, e tërhoqën iniciativën ligjvënëse.

Kodi Zgjedhor u miratua në seancë plenare me shumicën e nevojshme të deputetëve.

9. Projektligji “Kodi i Familjes i Republikës Shqipërisë”, (miratuar në seancë plenare më 8.5.2003)

Në pjesën e parë të Kodit trajtohen parimet më të rëndësishme për familjen dhe fëmijët. Projektligji synon mbështetjen e interesit më të lartë të fëmijës, ndihmën që duhet t’u japë shteti familjes dhe fëmijëve, detyrimin e shtetit kundrejt fëmijëve të ndodhur në vështirësi për të jetuar, si dhe sanksionimin e të drejtës së fëmijës për t’u dëgjuar nga gjykata. Në pjesën e dytë, trajtohet martesja, ku përfshihen kushtet thelbësore për lidhjen e saj, forma e lidhjes së martesës dhe pavlefshmëria e martesës. Në ndryshim nga Kodi në fuqi, mosha e lidhjes së martesës është përcaktuar 18 vjeç, si për gruan, ashtu edhe për burrin. Ndryshime janë bërë edhe në rregullimin e regjimit pasuror të bashkëshortëve, si dhe janë futur elemente të reja në fazën e zgjidhjes së martesës. Në pjesën e tretë trajtohen amësia dhe atësia, detyrimi për ushqim, përgjegjësitë prindërore, birësimi i të miturve. Si element i ri është futur periudha e provës për birësimin e të miturve nga shtetas shqiptarë. Elemente të reja janë futur edhe në trajtimin e kujdestarisë mbi të miturin dhe mbi personat që u është hequr ose u është kufizuar zotësia për të vepruar.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare deputetët bënë shumë ndryshime në formulimin e tij.

10. Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8085, datë 12.3.1996 (miratuar në seancë plenare më 9 korrik 2003)

Ndryshimet në Kodin e Punës synojnë të rregullojnë disa probleme që kanë lindur nga praktika e zbatimit të tij, si dhe të realizojnë përputhjen e ligjit me Kushtetutën, konventat ndërkombëtare, Kartën Sociale Europiane dhe udhëzimet e BE-së. Në projektligj parashikohen disa rregullime e plotësime në kontratën e punës, në të drejtat themelore, në rregullimin e detyrimeve të punëmarrësit dhe punëdhënësit, në sigurimin e një mbrojtjeje të veçantë për të miturit dhe gratë, mënyrën e dhënies dhe përdorimit të pagës, në përfundimin e marrëdhënieve të punës, në kohëzgjatjen e punës dhe të pushimeve etj.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në Komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare, deputetët bënë mjaft propozime dhe miratuan një sërë ndryshimesh në formulimin e disa neneve, të cilat synonin sigurimin e një raporti sa më të drejtë midis mbrojtjes së të drejtave të punëmarrësve nga njera anë dhe të punëdhënësve nga ana tjetër.

III. Rezoluta e deklarata të miratuara

1. Projektrezolutë e Komisionit të Përhershëm të Politikës së Jashtme për marrëdhëniet ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë (miratuar në seancë plenare më 12.6.2003)

Me nismë të Komisionit të Përhershëm të Politikës së Jashtme, Kuvendi miratoi një projektrezolutë për forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve miqësore me Greqinë, si dhe për kapërcimin e pengesave ligjore dhe zgjidhjen e problemeve ekzistuese, të cilat janë pasojë e ligjit të Luftës të vitit 1940. Në këtë projektrezolutë Kuvendi i kërkon Qeverisë Shqiptare të punojë për heqjen e pengesave për gëzimin e pasurive të

shtetasve të njëjës palë në territorin e palës tjetër, lehtësimin e procedurave për lëvizjen e shtetasve brenda kuadrit ligjor, si dhe përsheptimin e legalizimit të emigrantëve shqiptarë, mbi bazën e parametrave europianë. Kuvendi nxit qeveritë e të dy vendeve të punojnë për promovimin e të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve dhe shkollimin e ndërsjellë në gjuhën amtare të shtetasve në vendet e tyre.

2. Rezolutë e Kuvendit për forcimin e marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Bashkimit Europian (mbajtur në seancë plenare 17 prill 2003)

Në këtë Rezolutë, e cila është nismë e Komisionit të Përhershëm të Politikës së Jashtme, Kuvendi i kërkon Qeverisë që, në bashkëpunim me institucionet, forcat politike dhe shoqërinë civile, të shndërrojë Planin Strategjik për Integrim, në Strategji Kombëtare për Integrim në Bashkimin Europian. Në këtë Strategji kërkohet të detajohen hapat që do të ndërmerren për përmbushjen e të gjitha detyrimeve, si dhe plotësimi i standardeve që rrjedhin nga procesi i integritimit, në fushën e reformave dhe të përmirësimit të legjisllacionit. Kuvendi i kërkon Qeverisë të marrë të gjitha masat administrative dhe ligjvënëse për të zgjidhur çështjet që lidhen me luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe reformën institucionale.

3. Deklaratë për projekt-preambulën e kartës kushtetuese të unionit të ri “Serbi-Mal i Zi”

Me nismë të Komisionit të Përhershëm të Politikës së Jashtme, Kuvendi miratoi një deklaratë, e cila merr shkas nga një mesazh shqetësues që jep komisioni i përbashkët serbo-malazez, i cili në projektin e preambulës së kartës kushtetuese të Unionit Serbi-Mali i Zi, formulon përcaktimin për Kosovën si pjesë e Serbisë. Një përcaktim i tillë, sipas deklaratës, bie në kundërshtim të plotë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, e cila e sheh përcaktimin e statusit të Kosovës si një proces që bazohet në vullnetin e shprehur të popullit të Kosovës në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare dhe nuk parashikon ndonjë lloj sovraniteti të Serbisë ndaj Kosovës. Ky përcaktim sfidon popullin e Kosovës dhe të

bashkësisë ndërkombëtare, duke mos mbajtur parasysh vullnetin e tyre, synon t'i hapë rrugë qëndrimeve arbitrare dhe imponuese të një populli ndaj një populli tjetër.

Duke i parandjerë këto rreziqe, në këtë deklaratë Kuvendi fton parlamentet e Serbisë dhe të Malit të Zi të mos adaptojnë asnjë formulim që bie ndesh me vullnetin e lirë të Kosovës, si dhe i kërkon organizatave ndërkombëtare të tregojnë vëmendjen e duhur ndaj këtij zhvillimi provokues. Ai kërkon ndërhyrjen e Bashkimit Europian, për të kthyer në rrjedhë të arsyeshme procesin e formimit të unionit Serbi-Mali i Zi.

IV. Kontrolli Parlamentar.

Gjatë periudhës prill-korrik 2003 Kuvendi zhvilloi disa interpelanca e seanca pyetjesh, si dhe shqyrtoi disa mocione:

- Interpelancë me Kryeministrin, kërkuar nga deputeti Neritan Alibali, me objekt qëndrimin e Qeverisë mbi krimin e organizuar, trafiqet e paligjshme dhe korrupsionin në administratën shtetërore, si dhe masat që mendon të marrë Qeveria për t'i luftuar ato.

- Interpelancë me Ministrin e Rregullimit të Territorit e Turizmit, kërkuar nga deputeti Sokol Olldashi, me objekt strategjinë për përmirësimin e sektorit të turizmit, rritjen e investimeve të huaja dhe masat që parashikohen të merren nga Qeveria për thithjen dhe lehtësimin e procedurave që lejojnë investimet dhe zbatimin e projekteve.

- Interpelancë me Ministrin e Shëndetësisë, kërkuar nga deputetja Ermelinda Meksi, për strategjinë e kësaj Ministrie në fushën e uljes së vdekshmërisë së fëmijëve dhe të nënës dhe harmonizimin e kësaj strategjie me atë të reduktimit të varfërisë, për të arritur standardet europiane.

- Mocion për debat me Kryeministrin për mediat elektronike dhe të shkruara, (paraqitur nga Grupi parlamentar i PD-së), 23.6.2003

- Mocion për debat me Kryeministrin për aktet kriminale ndaj biznesit (paraqitur nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike).

Debati për këtë mocion u zhvillua në seancë plenare më datë 16 qershor

2003. Gjatë debatit mocionistët shprehën shqetësimin e tyre për aktet e fundit kriminale, rrëmbimet, vrasjet e biznesmenëve dhe të familjarëve të tyre, të cilat kanë tronditur opinionin publik shqiptar dhe kanë terrorizuar biznesin shqiptar dhe të huaj të interesuar për investime dhe për konkurrencën e lirë të tregut. Pas denoncimit prej tyre të qëndrimit indiferent të Qeverisë dhe strukturave të saj, për angazhimin e pamjaftueshëm të tyre në luftë kundër kësaj dukurie, mocionistët kërkuan zbardhjen e të vërtetës nga Prokuroria e Përgjithshme për aktet kriminale, ndëshkimin e tyre nga organet e drejtësisë dhe marrjen e masave ligjore e institucionale nga Qeveria për ta luftuar atë.

Në përfundim të debatit, Kuvendi miratoi një rezolutë, e cila ngarkon me detyrë Qeverinë që të rrisë forcën goditëse në luftë kundër krimeve dhe i kërkon Prokurorisë së Përgjithshme, Policisë së Shtetit dhe Shërbimit Informativ Shtetëror të zbardhin urgjent të vërtetën lidhur me këto krime.

Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend

Filip Lako

Jurist

Qendra e Studimeve Parlamentare

Ligj nr.8871, datë 29.3.2002 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”. Me ligjin e lartpërmendur bëhen dy ndryshime në ligjin nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”. Nga ligji në fuqi shfuqizohet pika 22/2 e nenit 22, ku parashikohet se Ministri i Financave, në emër të Këshillit të Ministrave, paraqet përpara Kuvendit Popullor projektbuxhetin e shtetit dhe jep shpjegimet e duhura rreth tij. Në nenin 23 pika 23/1 parashikon që në rast se deri më 31 dhjetor të çdo viti buxhetor Kuvendi Popullor nuk ka miratuar ende projektbuxhetin e shtetit për vitin buxhetor pasardhës, Këshilli i Ministrave miraton dhe zbaton buxhetin e shpenzimeve për një periudhë deri në 3 muaj nga dita e fillimit të vitit të ri buxhetor. Pika 23/2 e nenit 23 është shfuqizuar. Në këtë pikë parashikohej që me mbarimin e afatit tre mujor, treguar në pikën 23/1 të nenit 23, si u shkrua më sipër, shpenzimet buxhetore bëhen vetëm me dekret të veçantë të Presidentit të Republikës, por jo më shumë se tre muaj. Brenda këtij afati Kuvendi Popullor duhet të shprehet për Projektbuxhetin e vitit. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 3.5.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.11, viti 2002, faqe 319.

Ligj nr.8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”. Qëllimi i këtij ligji është të mbështesë zhvillimin e një sistemi të përbashkët të arsimit dhe formimit profesional në Republikën e Shqipërisë, i cili mund t’u përshtatet ndryshimeve shoqërore, ekonomike e teknologjike, nevojave të tregut të punës, si dhe të mundësojë një shfrytëzim optimal të burimeve financiare, njerëzore dhe infrastrukturore. Gjithashtu, ligji vendos parimet themelore, strukturën, organizimin dhe administrimin e arsimit dhe të formimit profesional në Republikën e Shqipërisë, mbështetur në bashkëpunimin e institucioneve shtetërore, qeveritare me partnerë socialë dhe aktorë të tjerë në fushën e arsimit dhe të formimit profesional. Në ligj janë parashikuar objektivat e arsimit dhe të formimit profesional, tipat e arsimit dhe të formimit profesional, si dhe institucionet e tyre. Gjithashtu në ligj rregullohen edhe problemet e regjistrimit, pranimit, kohëzgjatja (e cila është e ndryshme dhe në varësi të tipit) e vlerësimit përfundimtar etj. Në kreun e tretë flitet për bashkërendimin e përgjithshëm të punëve, bashkërendim, i cili bëhet nga shteti (Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale), si dhe për kompetencat e këtyre ministrive. Në kreun e katërt dhe të pestë rregullohen probleme të standardeve, të aftësive profesionale dhe klasifikimit të profesioneve, si dhe probleme të burimeve financiare. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen nenet 33, 34, 35, 36, 37, 38, 55 pika 4 dhe 57 pika 2 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”. Shfuqizohen, gjithashtu, paragrafi i dytë i nenit 5, neni 10 dhe shkronjat “b” dhe “c” të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”. Ligji ka 33 nene dhe ka hyrë në fuqi më 3.5.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.11, viti 2002, faqe 320.

Ligj nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”. Ky ligj ka për qëllim të rregullojë sigurimin dhe kompensimin e depozitave, si dhe krijimin, përgjegjësitë dhe veprimtarinë e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, depozitat në bankë sigurohen

nga Agjencia, sipas dispozitave të këtij ligji. Asnjë bankë nuk pranon dhe nuk grumbullon depozitë kur nuk është e siguruar nga Agjencia. Po këto rregulla, të drejta e detyrime zbatohen edhe për depozitat në degët e bankave të huaja që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Depozitat e siguruara mund të jenë në lekë ose në monedhë të huaj. Depozitat e sigurimeve të çdo depozituesi për çdo bankë të siguruar, të vendosura në disa llogari, depozitë, llogariten të gjitha së bashku dhe konsiderohen si një llogari depozitë e vetme. Kompensimi është 100 për qind për depozitat me 350 000 lekë ose më pak dhe 85 për qind për depozitat mbi 350 000 lekë deri në 700 000 lekë. Në ligj më tej flitet për detyrimet dhe të drejtat e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, për organizimin dhe drejtimin e Këshillit Drejtues të Agjencisë, për detyrat e Këshillit Drejtues, përbërjen e tij, për të drejtën për informacion dhe informimin e publikut etj. Ligji ka 33 nene dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr.11, viti 2002, faqe 330. Ligji hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare. Ai është botuar më 18.4.2002 dhe ka hyrë në fuqi më 18.10.2002.

Ligj nr.8874, datë 29.3.2002 “Për kontrollin e lëndëve që përdoren për fabrikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope”.Për kontrollin e lëndëve, që shpesh përdoren për fabrikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope, u bë i domosdoshëm miratimi i këtij ligji, me synimin për të parandaluar e shmangur nga destinacioni të lëndëve të tilla dhe në vendosjen e sanksioneve ndaj shkeljeve që përcaktohen në këtë ligj. Kreu i dytë i ligjit flet për autoritetet përgjegjëse për zbatimin e ligjit dhe për detyrat e tyre. Këtu gjejmë rregullim edhe problemet e pajisjeve me licencë dhe të regjistrimit të operatorëve (persona fizikë ose juridikë që merren me fabrikimin, prodhimin, magazinimin, tregtimin ose shpërndarjen e lëndëve të listuara, ose me importimin, eksportimin, tranzitimin e këtyre lëndëve). Në dy krerë të tjerë parashikohen rregulla për dokumentimin, regjistrat dhe etiketimin e lëndëve narkotike dhe psikotrope, si dhe për kontrollin dhe

inspektimin e operatorëve. Gjithashtu, parashikohen edhe detyrimet e këtyre të fundit për të bashkëpunuar me autoritetet e kontrollit. Në kreun e parafundit të ligjit janë vendosur rastet dhe veprimet që përbëjnë kundërvajtje administrative dhe gjobat ndaj tyre, si dhe rastet e bllokimit, konfiskimit dhe të asgjësimit të këtyre lëndëve. Ligji ka edhe 7 shtojca (standard) të cilat rregullojnë probleme të eksportit dhe importit të këtyre lëndëve. Shtojcat që shoqërojnë këtë ligj janë pjesë përbërëse e tij. Ligji ka 28 nene dhe ka hyrë në fuqi më 14.5.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.12, viti 2002, faqe 359.

Ligj nr.8875, datë 4.4.2002 “Për rojën bregdetare shqiptare”. Për zbatimin e ligjshmërisë në det, me këtë ligj krijohet Roja Bregdetare, e cila varet nga Ministria e Mbrojtjes dhe është pjesë e distrikteve detare, të cilat varen nga Komanda e Forcave Detare. Për kryerjen e detyrave të ngarkuara, oficerët e Rojes Bregdetare gëzojnë statusin e Policisë Gjyqësore, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Sipas këtij ligji, Roja Bregdetare, ndërmjet të tjerash, ka për detyrë të zbatojë legjislacionin shqiptar dhe normat e së drejtës ndërkombëtare të pranuar nga Republika e Shqipërisë në hapësirën detare shqiptare, të ushtrojë kontroll për zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit, peshkimin detar, lundrimin turistik, ruajtjen e pasurive detare dhe të vlerave arkeologjike në hapësirën detare shqiptare etj. Procedurat për kryerjen e detyrave nga Roja Bregdetare përcaktohen në Manualin e Rojes Bregdetare, i cili miratohet nga Këshilli i Ministrave. Në ligj parashikohen edhe kundërvajtjet administrative dhe masat administrative, fusha e veprimit dhe e bashkëpunimit me subjektet juridike e fizike vendase dhe të huaja etj. Ligji ka 12 nene dhe ka hyrë në fuqi më 28.5.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.15, viti 2002, faqe 435.

Ligj nr.8876, datë 4.4.2002 “Për shëndetin riprodhues”. Ky ligj rregullon organizimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha veprimtarive që zhvillohen në fushën e shëndetit riprodhues, në institucionet shëndetësore

private dhe publike, mbron të drejtat riprodhuese të individit e të çiftit dhe siguron që të drejtat riprodhuese të çdo individ të mbrohen në përputhje me ligjet dhe politikat kombëtare e me parime të tjera të njohura ndërkombëtare. Në kreun e dytë, ku flitet për të drejtat riprodhuese, ligji trajton në mënyrë të detajuar dhe garanton çdo individ lidhur me vendimmarrjen për ushtrimin e të drejtave riprodhuese sipas dëshirës dhe interesit të tyre të lirë nga diskriminimi, detyrimi dhe dhuna. Një kujdes i veçantë tregohet nga ligji në kreun e tretë, lidhur me organizimin e shërbimit të shëndetit riprodhues, duke i vënë detyrë Ministrin të Shëndetësisë të përcaktojë strukturat dhe shërbimet e shëndetit riprodhues, kriteret, rregullat e funksionimit të tyre, si dhe politikën e strategjinë e zhvillimit për shëndetin riprodhues. Gjithashtu, ligji trajton probleme të diagnostikimit para lindjes, të teknikave të riprodhimit mjekësor të asistuar, të inseminimit artificial dhe të fekondimit artificial in vitro. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, quhen kundërvajtje administrative dhe, në rast se këto kundërvajtje përsëriten, mund të hiqet e drejta e ushtrimit të profesionit, të bëhet sekuestrimi i pajisjeve dhe të kallëzohen për ndjekje penale. Ligji ka 45 nene dhe hyn në fuqi 3 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare. Ky botim është bërë më 13.5.2002, pra, ligji ka hyrë në fuqi më 13.8.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.15, viti 2002, faqe 438.

Ligj nr.8877, datë 4.4.2002 “Për krijimin e Agjencisë së Nxitjes së Investimeve të Huaja”. Me këtë ligj krijohet Agjencia e Nxitjes së Investimeve të Huaja, përcaktohet fusha e veprimtarisë, si dhe parimeve e rregullave të përgjithshme për organizimin dhe funksionimin e saj. Organizimi, funksionimi dhe veprimtaria e Agjencisë së Nxitjes të Investimeve të Huaja përcaktohet në statutin e saj. Statuti i Agjencisë miratohet nga Këshilli i Ministrave. Sipas këtij ligji, fusha e veprimtarisë së kësaj Agjencie është nxitja, tërheqja dhe mbështetja e investimeve të huaja, identifikimi i mundësive për investime, bashkëpunimi me institucione publike, financiare, organizata

të biznesit dhe investitorëve, dhënia e asistencës për lehtësimin e investimeve të huaja, publikimi i informacionit zyrtar për investimet në Shqipëri etj. Organet drejtuese të Agjencisë janë: Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtoria Ekzekutive. Përbërja e Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë, si dhe mënyra e masa e shpërblimit të anëtarëve të tij, caktohen nga Këshilli i Ministrave, kurse procedurat e emërimit dhe të lirimit nga detyra e Drejtorit Ekzekutiv përcaktohen në statusin e Agjencisë. Në ligj tregohen edhe burimet financiare të veprimtarisë së Agjencisë, por gjithësesi kjo veprimtari financohet nga Buxheti i Shtetit, në përputhje me situatën financiare. Ligji ka 10 nene dhe ka hyrë në fuqi më 28.5.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.15, viti 2002, faqe 446.

Ligj nr.8878, datë 15.4.2002 “Për ratifikimin e “Protokollit të bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Turke të Kooperimit Ndërkombëtar (TIKA) të Republikës së Turqisë””. Në këtë Protokoll janë palë Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit e Shqipërisë dhe Kryeministria Turke – Agjencia Turke e Kooperimit Ndërkombëtar (e quajtur TIKA). Qëllimi i këtij Protokollit është për mbarështimin e lopës së racës “xhersej” dhe për nxitjen e krijimit të shoqatave të fermerëve të mbarështimit të gjedhit “Xhersej” në rajonin e Malësisë së Madhe dhe të Shkodrës. Protokollit përmban detyrimet e TIKA-s dhe të Ministrisë Shqiptare të Bujqësisë dhe Ushqimit, përcakton se cilat janë institucionet ekzekutive dhe cilat janë detyrimet e përbashkëta midis palëve. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 28.5.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.15, viti 2002, faqe 448. Ligjit i bashkëlidhet Protokollit.

Ligj nr.8879, datë 15.4.2002 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së bashkëpunimit teknik e financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Turqisë””.

Sipas kësaj Marrëveshjeje, Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Turqisë kanë rënë dakord të nisin bashkëpunimin ekonomik e social ndërmjet dy vendeve. Programi i bashkëpunimit do të bashkërendohet nga Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë për palën shqiptare dhe nga Administrata Ndërkombëtare Turke për Bashkëpunim (TIKA) nën Këshillin e Ministrave për palën turke. Secila palë do të caktojë ekspertë që do të identifikojnë dhe përgatisin projektet në fushat e përcaktuara në një listë, ku ndër të tjera përfshihen: energjia, infrastruktura, sistemi financiar, bujqësia, blegtoria e peshkimi, turizmi, shëndetësia, mjedisi, arsimiti etj. Marrëveshja përcakton edhe përgjegjësitë e secilës palë në zbatimin e Marrëveshjes. Kështu, pala turke, ndërmjet të tjerash, do të hapë në Tiranë Zyrën e Bashkërendimit të Programit, do të zgjedhë, do të marrë dhe do të paguajë personelin e nevojshëm, do të mbështesë financiarisht mbulimin e shpenzimeve të studimit të fizibilitetit, do të sigurojë këshillim të nivelit të lartë etj. Pala shqiptare duhet të vërë në dispozicion të gjithë informacionin e kërkuar nga specialistët shqiptaro-turq, të mbulojë shpenzimet e specialistëve shqiptarë etj. Kohëzgjatja e Marrëveshjes është pesë vjet. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 28.5.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.15, viti 2002, faqe 451. Ligjit i bashkëlidhet Marrëveshja.

Ligj nr.8880, datë 15.4.2002 “Për të drejtat e seleksionerit të bimëve”. Seleksioneri i bimëve, sipas kuptimit të këtij ligji, është personi fizik ose juridik, si dhe çdo punëmarrës që ka seleksionuar, zbuluar dhe zhvilluar një varietet të ri bimor. Në këtë kontekst, qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e të drejtave të personave që seleksionojnë, zbulojnë dhe zhvillojnë varietete të reja bimore. Ligji parashikon kushtet për dhënien e të drejtës së seleksionerit, e drejtë e cila jepet kur varieteti është i ri, i dallueshëm, uniform, i qëndrueshëm dhe subjekt i një emërtimi të ri. Ligji rregullon, gjithashtu, edhe aplikimin për të drejtën e seleksionerit, duke saktësuar parimet bazë, përmbajtjen e aplikimit dhe përparësitë. Kreu i katërt i ligjit flet për shqyrtimin

e aplikimit, duke i dhënë këto procedura në mënyrë të detajuar, siç janë kërkesa, shqyrtimi paraprak, shqyrtimi teknik, dhënia ose mosdhënia e të drejtës së seleksionerit, e drejta e ankimit etj. Pas zgjidhjes së problemeve, që u përmendën më lart, gjejnë rregullim në ligj edhe të drejtat e zotëruesit, fusha e shtrirjes të kësaj të drejte, fushat kur nuk shtrihen këto të drejta, kohëzgjatja e të drejtës etj. Në kërret e tjerë të ligjit flitet për mbajtjen e të drejtës së seleksionerit, mbarimin e kësaj të drejte, për pronësinë e përbashkët, për autorizimet kontraktuese dhe të të drejtës për kundërvajtjet e masat administrative. Në ligj përcaktohet që Këshilli i Ministrave të nxjerrë akte nënligjore në zbatim të nenit 27 të këtij ligji, kurse Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit për nenet 10, 14, 15, 16, 24 dhe 28. Neni 4 i ligjit nr.8732, datë 24.1.2001 “Për materialin mbjellës bimor” shfuqizohet. Ligji ka 41 nene dhe ka hyrë në fuqi 28.5.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.15, viti 2002, faqe 454.

Ligj nr. 8881, datë 18.4.2002 “Për ratifikimin e “Kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për projektin e rrugëve europiane-Shqipëria”. Kontrata financiare për shumën 34 milionë euro është lidhur midis Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ministria e Transporteve dhe, nga ana tjetër, Banka Europiane e Investimeve. Kjo kontratë financiare është lidhur meqenëse Komuniteti Europian dhe Shqipëria kanë arritur në një “Marrëveshje midis Komunitetit Ekonomik Europian dhe Republikës së Shqipërisë në fushën e bashkëpunimit tregtar dhe ekonomik” në mbështetje të përpjekjeve të Shqipërisë për të kryer reforma politike dhe ekonomike. Kredia, në një shumë ekuivalente prej 34 milionë euro do të përdoret eskuzivisht për financimin e një pjese të kostove të projektit, i cili përfshin projektimin, shpronësimin, supervizionin, përmirësimin, rindërtimin dhe komisionin e seksioneve të rrugëve përparësore përgjatë pjesës ekzistuese jugore të korridorit Veri-Jug drejt kufirit grek. Këtu hyjnë segmentet Lushnjë-

Fier, Fier-Vlorë dhe Tepelenë-Gjirokastrë. Në kontratë parashikohen dhe u jepet zgjidhje problemeve të disbursimit, huasë, normës së interesit, shlyerjes së kredisë, pagesave, sipërmarrjeve të veçanta, sigurisë, informacionit etj. Kontrata ka të bashkëlidhur përshkrimin teknik (në përmasa standarde dhe minimum), si dhe Tabelën e Amortizimit, nga e cila del se kësti i parë i kredisë do të fillojë të paguhet më 15 qershor 2007 dhe kësti i fundit në 15 dhjetor 2025. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 30.5.2002, botuar në Fletoren Zyrtare nr.16, viti 2002, faqe 475. Ligjit i bashkëlidhet kontrata financiare, përshkrimi teknik dhe Tabela e Amortizimit.

Ligj nr.8882, datë 18.4.2002 “Për ratifikimin e “Protokollit shtesë të “Marrëveshjes Europiane për transmetimin e kërkesave për ndihmë gjyqësore dhe të raportit shpjegues””. Shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe palët e tjera në Marrëveshjen Europiane për Transmetimin e Kërkesave për Ndhimë Gjyqësore, nënshkruer të këtij Protokollit, me dëshirën për të përmirësuar efincencën e zbatimit të Marrëveshjes dhe për të plotësuar atë në disa aspekte, sidomos në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me ndihmën gjyqësore, kanë rënë dakord që me anë të këtij Protokollit shtesë, të përmirësojnë dhe plotësojnë në disa aspekte dispozitat e Marrëveshjes midis palëve të Protokollit (nënshkruar në Strasburg më 27 janar 1977). Pra, ligji i lartpërmendur ratifikon këtë Protokoll shtesë. Ky i fundit trajton probleme të bashkëpunimit ndërmjet palëve, të komunikimit ndërmjet avokatëve dhe paraqitësve të kërkesës, prek probleme të efincens së procedurave etj. Shteti që ratifikon këtë Protokoll nuk mund të bëjë asnjë rezervë në lidhje me dispozitat e tij, por i lihet e drejta të caktojë territorin ose territoret tek të cilët do të zbatohet ky Protokoll. Çdo palë kontraktuese, për aq sa është ingranuar, mund të denoncojë këtë Protokoll nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshën të Këshillit të Europës. Protokollit i bashkëlidhet një raport shpjegues, si dhe një koment mbi nenet e Protokollit shtesë. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 30.5.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.16, viti 2002, faqe 492.

Ligj nr.8883, datë 18.4.2002 “Për ratifikimin e “Protokollit të dytë shtesë të “Konventës së Këshillit të Europës për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale””. Shtetet anëtare të Këshillit të Europës që e kanë nënshkruar këtë Protokoll, duke dashur të kontribuojnë më tej për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, për respektimin e shtetit të së drejtës dhe mbështetjen për një shoqëri demokratike, me këtë Protokoll të dytë shtesë vendosën të përmirësojnë dhe të shtojnë aspekte të caktuara të Konventës Europiane për Ndihmë të Ndërsjellë Gjyqësore në Fushën Penale. (Bërë në Strasburg më 20 prill 1959). Sipas Konventës, palët i japin njëra-tjetrës ndihmë të ndërsjellë gjyqësore, dhe Protokollit i dytë shtesë bën plotësim dhe rregullime lidhur me transferimin e përkohshëm të personave të dënuar në territorin e palës kërkuese për qëllime dëshmie dhe jo për t’u gjykuar. Sipas Protokollit, kërkesa për asistencë të ndërsjellë, si dhe për informacionin spontan do të adresohet me shkrim nga Ministria e Drejtësisë e palës kërkuese, te Ministria e Drejtësisë e palës së kërkuar. Protokollit parashikon dhe zgjidh problemet e shpenzimeve, të proceseve të dëgjimit me video, të seancave të dëgjimit me anë të konferencave telefonike, të informacionit spontan, të transferimit të përkohshëm të personave të ndaluar për te palët e kërkuara, të shërbimit me postë, të gjuhës që do të përdoret në këto dokumente etj. Me detaje e rëndësi të veçantë Protokollit trajton probleme të hetimeve sekrete, të hetimeve të përbashkëta, të mbrojtjes të dëshmitarëve dhe të të dhënave etj. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 30.5.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.17, viti 2002, faqe 509. Ligjit i bashkëlidhet Protokollit i Dytë Shtesë (i hartuar në Strasburg më 8.11.2001).

Ligj nr.8884, datë 22.4.2002 “Për një ndryshim në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e nismës së lirë të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit””, ndryshuar me ligjet nr.7653, datë 23.12.1992, nr.7723, datë 21.6.1993, nr.7925, datë 19.4.1995, nr.8159, datë 7.11. 1996 dhe nr.8333 datë 23.4.1998. Ligji

nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, sikurse shihet edhe nga titulli, ka pësuar pesë ndryshime. Me ligjin e lartpërmendur bëhet ndryshimi i gjashtë. Në tekstin e ligjit bazë, pra, në atë me numër 7512, datë 10.8.1991 fjalët “Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit”, që sipas ligjit të lartpërmendur (numër 8884, datë 22.4.2002) ndryshohen, nuk figurojnë. Me sa kuptohet këto fjalë i takojnë ndryshimeve të mëvonshme, dhe me ligjin nr.8884, datë 22.4.2002 përsëri ndryshohen dhe zëvendësohen me fjalët “Ministria e Ekonomisë”. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 30.5.2002, por i shtrin efektet e tij që prej datës 22.2.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.17, viti 2002.

Ligj nr.8885, datë 22.4.2002 “Për një ndryshim në ligjin nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndër marrjeve shtetërore në shoqëri tregtare””, ndryshuar me ligjet nr.8067, datë 15.2.1996, nr.8099, datë 28.3.1996, nr.8158, datë 7.11.1996, nr.8237, datë 1.9.1997, nr.8482, datë 10.5.1999 dhe me dekret nr.1195, datë 14.8.1995 dhe nr.1615, datë 20.9.1996. Me ligjin e lartpërmendur bëhen dy ndryshime. Në gjithë përmbajtjen e ligjit (i cili ka pësuar pesë ndryshime me ligje dhe dy ndryshime me dekrete), fjalët “Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit” zëvendësohen me fjalët “Ministria e Ekonomisë”. Në nenin 8 paragrafi i katërt ndryshohet si vijon: “Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës emërohen nga Ministri i Ekonomisë, por 2/3 e anëtarëve të Këshilli propozohen nga ministrinë dhe institucionet përkatëse që varen drejtpërdrejt nga Këshilli i Ministrave, si dhe organet përkatëse të pushtetit vendor.” Paragrafi i tretë i nenit 8 hiqet. Ligji ka 3 nene dhe ka hyrë në fuqi më 30.5.2002 dhe i shtrin efektet që prej datës 22.2.2002.

Ligj nr.8886, datë 22.4.2002 “Për një ndryshim në ligjin nr.8334, datë 23.4.1998 “Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë””. Me këtë ligj, në gjithë tekstin e ligjit nr.8334,

datë 23.4.1998 “Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, fjalët “Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit”, zëvendësohen me fjalët “Ministria e Ekonomisë”. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 30.5.2002 dhe i shtrin efektet që prej datës 22.2.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.17, viti 2002, faqe 524.

Ligj nr.8887, datë 22.4.2002 “Për një ndryshim në ligjin nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë””, ndryshuar me ligjin nr.8459, datë 23.2.2000”. Me ligjin e lartpërmendur bëhet vetëm një ndryshim që ka të bëjë me emërtim. Kështu, në nenin 13 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë” (ndryshuar me dy ligje të mëvonshme) fjalët “Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit”, zëvendësohen me fjalët “Ministria e Ekonomisë”. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 30.5.2002 dhe i shtrin efektet që prej datës 22.2.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.17, viti 2002, faqe 524.

Ligj nr.8888, datë 25.4.2002 “Për ratifikimin e “Konventës për krimet në fushën e kibernetikës””. Qëllimi i këtij ligji që ratifikon Konventën e lartpërmendur është diktuar nga nevoja për bashkëpunim ndërmjet shteteve dhe industrisë private në luftimin e krimit kibernetik dhe nga nevoja për të mbrojtur interesat legjitime në përdorimin dhe zhvillimin e teknologjive të informacionit. Konventa trajton masat që duhet të merren në nivelin kombëtar ndaj hyrjeve të paligjshme, interceptimit të paligjshëm, interferencës së të dhënave e sistemeve, keqpërdorimit të pajisjeve etj. Zgjidhen, gjithashtu, probleme lidhur me falsifikimet e mashtrimet me kompjuterat, probleme të veprave penale të lidhura me pornografinë e fëmijëve, me dhunimin e të drejtës së autorit dhe të të drejtave të tjera lidhur me të, si dhe sanksionet në raste të tilla, duke trajtuar bashkëpunimin ndërkombëtar për çështje penale, si dhe probleme të ekstradimit midis palëve

për veprat penale, me kusht që ato të jenë të dënueshme sipas ligjit të të dy palëve të interesuara, me heqje lirie për një periudhë maksimale prej të paktën një vit os me një dënim më të rëndë. Rëndësi i kushtohet në Konventë parimeve të përgjithshme në lidhje me ndihmën e ndërsjellë, procedurave lidhur me kërkesat për ndihmë të ndërsjellë, ndihmën e ndërsjellë juridike në lidhje me masat e përkohshme dhe me kompetencë hetimi etj. Në nenin 42 të Koventës flitet për rezervat që mund të ketë çdo shtet në çastin e ratifikimit të saj. Nisur nga kjo e drejtë, me këtë ligj, ratifikohet, duke ruajtur ose duke rezervuar Republika e Shqipërisë të drejtën për të mos parashikuar përgjegjësi penale në rrethana të kufizuara sipas paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 10, me kusht që të parashikohen zhdëmtime të tjera, të cilët nuk shmangin përgjegjësinë ndaj dëmit të shkaktuar dhe nuk e shmangin Republikën e Shqipërisë nga detyrimet ndërkombëtare. Ligji ka 3 nene dhe ka hyrë në fuqi më 2.6.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.18, viti 2002, faqe 553. Ligjit i është bashkëlidhur Konventa.

Ligj nr.8889, datë 25.4.2002 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë””, ndryshuar me ligjet nr.7932, datë 17.5.1995, nr.8286, datë 16.2.1998, nr.8392, datë 2.9.1998, nr.8575, datë 3.2.2000, nr.8776, datë 26.4.2001 dhe nr.8852, datë 27.12.2001”. Sikurse shihet dhe nga titulli i ligjit, ndryshimet në ligjin bazë janë të shumta. Kështu, janë bërë gjashtë ndryshime dhe ky i fundit është i shtati. Ndryshimet në nenet 10 dhe 14 kanë të bëjnë me kontributet. Kështu, kontributi që paguhet për sigurimet shoqërore në fondet e sigurimeve për sëmundje, barrë-lindje dhe pension, për punëdhënësin ulet nga 26 për qind në 23.5. për qind e pagës bruto dhe për pensionin e personin e punësuar nga 10 për qind në 9.5 për qind e pagës bruto. Në nenin 30, kur tregohet se cilat pensione paguhen në degën e sigurimit të pensioneve, pas shkronjës “b” (pension pleqërie i pjesshëm) shtohet shkronja “b/1” (pension pleqërie i reduktuar). Në nenin

31 ku flitet për kontributet e përfitimit të pensionit të plotë të pleqërisë, për të përfutuar këtë lloj pensioni kërkohet moshë 65 vjeç për burrat dhe 60 vjeç për gratë nga sa ishte përkatësisht 60 dhe 55 vjeç. Pas nenit 31 shtohet neni 31/1, i cili zgjidh problemin e pensionit të pleqërisë së reduktuar. Për të fituar këtë lloj pensioni personi i siguruar duhet që të ketë jo më pak se 35 vjet sigurim dhe të ketë mbushur moshën 62 vjeç burrat dhe 57 vjeç gratë, kur moshë e daljes në pension të plotë pleqërie është më e madhe se këto moshë. Edhe në nenin 34 bëhet korigjimi i moshës, kur janë rastet e përfitimit të pensionit të pjesshëm, kur kanë më pak kohë sigurimi se sa duhet. Kështu, për burrat kërkohet moshë 65 vjeç dhe për gratë 60 vjeç. Ndryshimet në paragrafin e fundit të pikës 1 të nenit 90 kanë të bëjnë me masën e kontributeve që do të derdhen të punësuarit dhe që bëhet nga 10 për qind në 9.5 për qind. Pas nenit 90 ndodhen tabelat me moshat dhe periudhën e sigurimit që kërkohet për secilën kategori, si për pensionin e plotë edhe për atë të pjesshëm. Ligji ka 11 nene dhe ka hyrë në fuqi më 1 korrik 2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.18, viti 2002, faqe 575.

Ligj nr. 8890, datë 2.5.2002 “Për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Komisionit Europian, në kuadër të programit “CARDS 2001””. Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Komisioni i Komiteteve Europiane, në kuadër të Programit mbështetës për Shqipërinë më 2001, kanë rënë dakord për këtë Marrëveshje Financiare si pjesë e programit të ndihmës. Komiteti do të kontribuojë me 37.5 milion euro, si Granti i KE-së. Në anekset e kësaj Marrëveshje Financiare zgjidhen probleme që kanë të bëjnë me financimin e projekteve, dhënien e lehtësirave, realizimin e kontratave, bashkëpunimin ndërmjet Komisionit dhe përfituesit etj. Në aneksin “B” flitet për probleme të Arbitrazhit, kurse aneksi “C” ka përshkrimin e masave, objektivat e programit, veprimtaritë, zbatimin, monitorimin etj. Sipas kësaj Marrëveshjeje, qëllimi i asistencës është të mbështesë pjesëmarrjen e

Shqipërisë në procesin e stabilizim- asociimit (SAP). Objektivat kryesorë specifike të kësaj asistence janë: kontributi për të rritur kapacitetin e Shqipërisë në aspektin e sigurisë dhe të rendit publik, forcimi i rregullit dhe ligjit, qeverisje e mirë dhe respekti për të drejtat e njeriut, krijimi i kushteve të përshtatshme për bashkëpunimin rajonal, forcimi i financave publike, rritja e të ardhurave nga doganat dhe taksat, forcimi i standardeve dhe çertifikimit, forcimi i bashkërendimit të ndihmës, rritja e kualitetit të arsimit të lartë etj. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 11.2.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.19, viti 2002, faqe 593. Ligjit i bashkëlidhet Marrëveshja Financiare, analizat “A”, “B” dhe “C”.

Albania and Europe: Perceptions and Realities

Raymond Detrez*
University of Ghent
Belgium

The relations between Albania and Europe is a theme that has fascinated not only historians and political scientists, but also writers and artists for the last two hundred years - in Europe as well as in Albania. These relations consisted of diplomatic contacts, commercial relations, military alliances and conflicts *et cetera*, but have transpired also in the peculiar way Albania has been perceived or rather imagined in Europe. The imagining of Albania may seem at first sight to have nothing in common with the very unimaginative process of European and Euro-Atlantic integration. However, our way of perceiving or imagining a person, a community or a country may deeply influence our disposition towards them and consequently our way of dealing with them. To be sure, the perception of Albania cannot be separated from the perception of the Balkans in general, which has recently attracted the attention of a number of scholars. ⁽¹⁾

The question whether the Balkans belongs to Europe or not needs first of all to be exposed as rather tricky. It suggests that there may be a

¹ E.g. Bakiaë-Hayden, Milica. 'Nestling Orientalism: The Case of Former Yugoslavia'. *Slavic Review* 54 (1995), nr. 4, 917-931; Todorova, Maria. *Imagining the Balkans*. New York, Oxford: Oxford University Press, 1997; Goldsworthy, Vesna. *Inventing Ruretanian. The Imperialism of Imagination*. New Haven, London: Yale University Press, 1998.

problem with the ‘Europeanness’ of the Balkans. At the beginning of the nineties, there was a tendency in Western Europe and the United States to accept the Central European nations as being genuinely European, and to exclude the Balkans from Europe – for reasons, which had to do mainly with the wars in Yugoslavia. In the light of European integration, ethnic-hatred, nationalism and separatism were branded as highly un-European features – as if these features had ever been absent from European history. Out of carelessness or ignorance, those wars, although they raged exclusively within the borders of Yugoslavia, were often called ‘Balkan wars’ by journalists and politicians, as if the entirety of the Balkans were involved in them. As a result not only Yugoslavia, but the whole peninsula got stigmatized and was denied the privilege to be called ‘European’. This implied the doors to the European institutions and especially to the European Union for the time being remained closed. It may be considered the irony of history – or the irony of the European enlargement - that now countries like Albania, Bulgaria and Romania are likely to join the EU via the Stabilization Pact for Southeast Europe in an earlier stage than was anticipated, ‘thanks to’ the reputation as troublemakers they undeservedly acquired because of Yugoslavia. In this case again, they are not accepted because they are actually considered as ‘European’ nations, but rather as a remedy to their alleged lack of Europeanness.

Belonging to Europe can mean many things. There is a purely geographic criterion. There is the criterion of European cultural identity, of European cultural traditions and European values. From this point of view, ‘Europeanness’ is something like an honorary title. In addition, there is Europe as a political construction, comprising a number of institutions, which may accept you as a member or not, thus making available to you or not the benefits of membership. It may be flattering to be considered European in the cultural sense, but it is far more interesting to be European institutionally. However, every candidate-member to the European institutions is supposed

first to acquire to a certain extent a European cultural identity, to show its commitment to European values, before becoming eligible as a formal member of these institutions.

How to evaluate the position of Albania in the light of these different interpretations of Europeanness? Let us consider, to start with, the trivial, but important fact that Albania is a part of the geographic entity called Europe. If Europe is to be united in a large, federation-like structure, stretching over almost the whole of the continent, there is no possibility to leave Albania out. As Romano Prodi pointed out during his visit to Tirana in January 2003: ‘The Balkans are an integral part of Europe and the process of unifying our continent will be complete only when the Balkan countries have become part of the Union.’⁽²⁾ Albania has now already a common border with one of the EU member states, Greece, and is separated from another member state, Italy, only by seventy kilometers of sea. As the enlargement of the European Union proceeds, the Balkan countries will increasingly be involved in the process and it is unthinkable that Albania or whatever other Balkan country will be left out and remain a small island of non-EU territory within the European Union. Even Switzerland, which for the time being prefers to remain outside the Union, is linked to the European Union in many ways already and in all likelihood will ultimately become a member of the European Union as well. The more suspicious among us may call this expansionism, but this kind of absorbing new territories seems to be the historical pattern according to which huge state-like territorial formations like the European Union develop. It seems in some cases to be for the benefit of the territories concerned.

² ‘Albania’s European Destiny’. Speech by Romano Prodi. (http://europa.eu.int/comm/external_relations/news/prodi/spal03/htm)

Is Albania – and the same goes for the whole of the Balkans - a part of Europe from a historical point of view? Did Albania participate in and contribute to the development and the establishment of the historical entity we now call Europe. It is a bit ironic to speak about this in the neighborhood of Durrës – the city that in my opinion gives the answer to this question. In antiquity, Durrës was one of the main arbors of the Roman Empire, situated on the *Via Egnatia*, one of the arterial roads in the Roman Empire, linking Rome with Constantinople. At that time Durrës was, as archaeological excavations and ancient monuments abundantly demonstrate, an important center of Greek and Roman civilization. The city occupies a particular place in the history of the conquests of the Normans, who ruled over Sicily and Southern Italy, and in the history of the Crusades. It was one of the main ports of the Venetian maritime empire. In other words, the history of this city is so tightly connected with major European historical events and developments that there is no reason for denying it a place in Europe. And this goes also for Vlorë, Korçë, Shkodër, Gjirokastër and many others cities in Albania, and finally for the country as a whole.

The usual objection to the Europeanness of the Balkans and consequently of Albania is that the peninsula was separated from Europe as a result of the Ottoman conquest of the region and the ensuing Ottoman domination, which lasted for nearly five centuries. This traditional way of understanding, which actually limits Europe to Western and Central Europe, continues to be very popular, not only in (Western) Europe, but also in the Balkans itself. Some contemporary historians, however, having surmounted traditional Eurocentricism and adhering to a more global approach to history, prefer to see Europe as merely a component of the economic, political and cultural area formed by the Mediterranean, and from this perspective fully acknowledge the prominent role the Ottoman Empire played in European history. Robert Mantran, editor and co-author of one of the most authoritative histories of the Ottoman Empire, wrote: ‘Une histoire de l’Europe, une histoire

du monde méditerranéen ne seraient pas complètes si l'on oubliait l'Empire ottoman.' ⁽³⁾ There existed normal commercial and diplomatic relations between European powers and the Ottomans, there were periods of rivalry and conflict, but also of collaboration and even admiration, shortly, there existed more or less the same relations between the Empire and the European nations as between the European nations themselves. Significantly, in the 19th-century, the Ottoman Empire was called 'the ill man ... of Europe'. Albanians played a prominent role in the military and political life of the Ottoman Empire. Stavrianos points out that '[o]ut of forty-nine grand vizirs in the period 1453 to 1623, eleven were Albanians, eleven were South Slavs, only five were Turks (...). Likewise, in the late nineteenth century Abdul Hamid depended to a large extent upon the Albanians, whom he trusted above his other subjects. The Palace Guard and the First Army Corps, which garrisoned the capital, consisted largely of Albanians.' ⁽⁴⁾ All the achievements of these people can be considered a part of European history as well.

Of great relevance in this regard is the *Tanzimat* period in Ottoman history – a period of large-scale reforms, aimed to ultimately transform the Empire into a modern constitutional monarchy. It is a period of Westernization, during which in the whole Empire and especially in the Balkans Western technology (like telegraph services and railways), but also Western institutions like ministries, public education, public health care *et cetera* were introduced and finally also Western attitudes and values were adopted. There was of course a considerable opposition movement against the *Tanzimat*, launched by the clergy (Islamic and Christian) and the feudal lords. One may point out that the reforms were imposed by the Western powers and

³ Mantran, Robert (ed.). *Histoire de l'Empire Ottoman*. Paris : Fayard, 1989, 12.

⁴ Stavrianos, L. S.. *The Balkans since 1453*. London: Hurst Company, 2000 [1958], 501.

have doubts about the sincerity of the ruling class, carrying out the entire operation, but it can not be denied that the *Tanzimat* in the final analysis fundamentally contributed to the emergence of a category of Western-minded intellectuals, who were eager to introduce Western innovations and especially the Western parliamentary system, convinced that it could help making their country more prosperous and more democratic. In Albania, Naim and Mid'hat Frashëri and Faik Konica are the best examples of this kind of liberal intellectuals. However, reading attentively their articles, pamphlets and books, one will notice that they did not consider the reforms they proposed as the introduction of some totally new and unknown European values in an unprepared, backward environment, but rather as a kind of activating the basic democratic values that had always been immanently present in their own traditional culture as well. In Balkan society the concern for education, social justice, democratic self-government and the like was never absent and did not differ fundamentally from Western European practice in spite of the different, less favorable conditions, resources and opportunities. The Westernization of the Balkans was a process, which actually continued, stimulated, and channeled practices and aspirations, embedded already in Balkan society.

Although the Albanians were very well integrated in the economic, political and military structures of the Ottoman Empire, Albania itself, as a country, remained to a large extent a blind hole in the knowledge of the average Western European. Many geographers traveled through the country, but, as one of them remarked, Europe was better informed about Black Africa than about Albania. Neither the high mountains, nor the allegedly savage nature of their inhabitants were the reasons of this ignorance. The lack of knowledge about and interest in Albania was caused in the first place by the relatively late emergence of an Albanian national movement, urging politicians and journalists in Europe to become familiar with the 'Albanian question'. In addition, there was hardly any academic interest in Albania and the

Albanians. Classic philologists would get interested in Modern Greek language and culture, and Slavic philologists in the Slavic Balkan countries, but none of the traditional philologies would induce scholars to make Albania and the Albanians their field of research. Today there are still to few universities, where Albanian is taught, although there is some improvement.

After the Second World War, Albania isolated itself from the rest of the world, limiting its international contacts mainly to the Soviet Union and China successively. This contributed to Albania being perceived even more as a self-contained, unfathomable country. Albania's isolationist policy during the communist period, combined with the ignorance in the West, resulted in a Western perception of Albania, marked by what Mariella Pandolfi called the folklorization or exoticization of Albania.⁽⁵⁾ According to her, Albania's acting in international politics and the behavior of the Albanians itself tend to be explained by systematically referring to folklore or by ascribing to the Albanians a particular, unchangeable and exotic psychological make-up. Instead of investigating into the actual political, economic and social conditions, many Western 'experts' still prefer to bring forward the alleged martial and clanish mentality of the Albanians, pointing to the many hundreds of thousands of bunkers, scattered over the land, or to the old *Kanun*.⁽⁶⁾ National character, however, is always a very secondary and a rather tricky explanation of events and developments in society, when a multitude of other, more

⁵ Pandolfi, Maria. 'Myths and New Forms of Governance in Albania'. *Albanian Identities. Myth and History*. Edited by Stephanie Schwandner-Sievers and Bernd J. Fischer. London: Hurst & Company, 2002, 205.

⁶ Offering a very luxurious edition of the *Kanun* in English translation to tourists, Albanian booksellers unintentionally reinforced this folkloristic perception of the Albanians among foreigners. (Gjeçov, Shtjefën. *Kanuni i Lekë Dukagjinit. The Code of Lekë Dukagjinit*. Translated, with an Introduction, by Leonard Fox. New York: Gjonlekaj Publishing Company, 1989.)

plausible and measurable economic and social conditions can be referred to. In Albania, however, the old essentialist stereotypes, generated by ignorance, appeared to be particularly tenacious.

Prejudices and stereotypes seldom are very consistent. In addition to the perception of Albania as a lonely fortress, there is the rather contradictory perception of Albania as a country, greatly depending on interventions and support from abroad. Albania came into being as an independent country in 1912 during the Balkan Wars, in extremely difficult and chaotic circumstances. It succeeded thanks to the support of the Great Powers, who enforced the other Balkan states to accept Albania's independence. For some years, Albania was administered by the same powers. During the First World War, Italy, France and Austria partitioned Albania. In 1939, Italy occupied Albania. During the Second World War and the first years after, the Albanian communist party was to a large extent dominated by the Yugoslav communists. Some are inclined to see a parallel between Western intervention just after the proclamation of Albanian independence, and the current presence of the NATO and the OCSE. There is indeed a long history of foreign interventions and interferences, but as they were often imposed and did not always serve Albanian interests, they do not necessarily show Albania's dependency on them. Actually, in some cases they tell us more about the policies of the Great Powers and of Albania's neighbors than about the mentality of the Albanians.

If isolation, distrustfulness and patriarchal conservatism were so typical of the Albanian people, one wonders how the Albanians succeeded, after more than forty years of severe totalitarian dictatorship and isolation, to open up to the world so quickly, to get familiar with the technological achievements of modern Western society and with the internationally accepted and applied standards and rules concerning free market economy, parliamentary democracy, human rights *et cetera*? Again Pandolfi writes, commenting on the stereotypes about Albania and the Albanians:

‘That many Western interventions in Albania are still informed by such stereotypes attests to the robustness of essentialist representations - despite the fact that many civilian and military experts who have worked or directly interacted with sectors of Albanian society have been impressed by the high level of schooling, and the familiarity with foreign languages of the younger generation of Albanians, who gained easy access to scholarships to study abroad.’⁷⁾

